

## RAPORTI VJETOR 2019

# INSTITUTI I STUDIMIT TË KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI



## **Përmbajtja**

### **I. PASQYRË PËRMBLEDHËSE E AKTIVITETIT TË ISKK GJATË VITIT 2019**

i. Misioni.....	1
ii. Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit.....	2
iii. Konkluzionet.....	14

### **II. AKTIVITETET**

#### **1. KONFERENCA/KUALIFIKIME**

1.1 Konferenca të organizuara nga ISKK.....	16
1.2 Bashkëpunime.....	22
1.3 Kontribute në konferenca/ Takime.....	29

#### **2. PROJEKTET**

2.1 Projekte arsimore.....	31
2.2 Projekte informuese-sensibilizuese .....	36
2.3 Projektet dokumentuese.....	41

#### **3. BOTIMET**

3.1 Botimet studimore/dokumentuese .....	45
3.2 Botime memuaristike.....	51
3.3 Literaturë nga burgjet/kampet .....	54

#### **4. PARTNERITETE**

4.1 Partnerë vendas.....	55
4.2 Partnerë ndërkombëtarë.....	55

#### **III. MENAXHIMI BUXHETOR**

a. Menaxhimi i burimeve njerëzore .....	56
b. Gjëndja financiare e iskk për vitin 2019 .....	57

#### **IV. PËRMBLEDHËSE NGA AUDITI I KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT**

a. Propozime për përmirësime të Legjislacionit në fuqi .....	60
b. Masa organizative .....	60

#### **V. VIZIONI PËR VITIN 2020.....**

62

## **i. Misioni**

Misioni dhe qëllimi i punës së Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit është grumbullimi, studimi, analizimi, evidentimi i fakteve dhe informimi i publikut në lidhje me periudhën komuniste në Shqipëri, në të gjitha aspektet e tij. Sipas nenit 5, të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, detyrat e këtij instituti janë:

- a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;
- b) analizon, studion dhe dokumenton krimet e kryera nga organet e diktaturës komuniste, si dhe pasojat gjatë dhe pas periudhës së komunizmit;
- c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;
- ç) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;
- d) studion dhe vlerëson veprimtarinë kriminale të Partisë Komuniste të Shqipërisë, më pas të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera, të krijuara në mbështetje të ideologjisë së saj;
- dh) analizon shkaqet dhe rrugët e vendosjes së regjimit komunist, dokumentet, që vërtetojnë përfshirjen e personave shqiptarë a të huaj, që mbështetën ardhjen e këtij regjimi, si dhe të atyre, të cilët bënë rezistencë kundër këtij regjimi;
- e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;
- ë) evidenton personat, që kanë qenë pjesë e organeve apo autoriteteve vendimmarrëse, përgjegjëse për propagandën komuniste, për aktet administrative dhe vendimet, të cilat kanë çuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, në veprime represioni, në jetën shoqërore dhe kulturore, përfshirë luftën e klasave, kolektivizimin, luftën kundër fesë, izolimin nga Perëndimi, pamundësinë për t'u informuar dhe censurën në art, kulturë e shkencë, si dhe kufizimin e furnizimit me ushqime, përmes tallonave të ushqimit;
- f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;
- g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;
- gj) përpunon, në formë elektronike, të gjithë dokumentacionin për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;
- h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri;

- i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;
- j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri;
- k) bashkëpunon me institucionet homologe të huaja

## **ii. Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit**

Gjatë vitit 2019, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit ka arritur përgjithësisht të përmbushë objektivat e parashikuara që në fillim të vitit 2019, si edhe objektivat e tjera të cilat vijuan në përgjigje të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, të lëshuar në muajin maj 2019. Në varësi të këtyre objektivave, ISKK realizoi një seri projektesh, ku ndër më të rëndësishmet mund të konsiderohen: hartimi dhe botimi i volumnit të 8-të të “Fjalorit enciklopedik i viktimave të terrorit komunist”; përgatitja për shtyp e volumnit të 6-të të serisë “Zërat e kujtesës”; prodhimi i pjesës së parë të vide-produksionit “Muzeut virtual i Kampit të Maliqit në 3D”; realizimi dhe përgatitja për shtyp e studimit “Abuzimi me pronën në Shqipërinë komuniste: 1945-1946”; përgatitja për shtyp e 16 librave të tjerë të natyrës së memuarit, publicistikës, studimit, me autorë bashkëpunëtorë të jashtëm të Institutit; realizimi i dy konferencave shkencore (një konference mbi trashëgiminë materiale dhe një konference tjetër mbi trajtimin e gruas në komunizëm), realizimi i 6 mini-konferencave (tubimeve, prezantimeve, etj) dhe bashkëpunimi në konferenca të tjera të organizuara nga institucionet partnere; hapja e një ekspozitë fotografike mbi realitetin dhe propagandën në komunizëm, etj.

Ndërkohë, për shkak të situatës dhe rrethanave jonormale, të paparashikuara, të krijuara gjatë vitit, duke e vështirësuar ndjeshëm ecurinë e zbatimit të programit, janë shtyrë për më vonë, ose nuk janë realizuar plotësisht disa aktivitete, si janë: shtyrja e procesit të shtypshkrimitsë kolanës vjetore për vitin në vazhdim ndërkohë që tekstet janë përgatitur; realizimi i 30 orëve video-regjistrimi të dëshmimeve (nga 60 orë të parashikuara në fillim të vitit); një shifër më e dobët e bisedave nëpër shkolla dhe vonesa në përgatitjen grafike të ekspozitës fotografike online “Para dhe pas”.

Më poshtë, po ju parashtröjmë arsyet dhe rrethanat e pazakonta, me të cilat iu desh institucionit të ndeshëj gjatë vitit 2019, si dhe efektin e tyre:

1. Edhe gjatë vitit 2019, vazhdoi të mbetet i kufizuar numri i stafit të punonjësve. Ndërkohë që plani vjetor i aktiviteteve është parashikuar duke llogaritur edhe katër vendet e reja të punës për të cilin është akorduar edhe buxheti, mosaprovimi i këtyre vendeve të punës, bëri që stafi ekzistues i ISKK të punojë edhe jashtë orarit zyrtar, duke vështirësuar edhe ndarjen

e punës, mungesën e profilizimit të punës dhe koordinimin në grupe. Kjo ka sjellë vonesa dhe mangësi në realizimin e projekteve.

2. Dorëheqja e Drejtorit Ekzekutiv të ISKK, zotit Agron Tufa, në fund të muajit nëntor, jo vetëm që krijoi një tjetër vakuum në staf, por pasoi edhe me pengesa të natyrës burokratike, duke e vështirësuar edhe më shumë zbatimin e projekteve në kohë.
3. Dorëheqja e njërit prej specialistëve të I-rë në fillim të muajit dhjetor, e thelloi problemin e mangësive në ekip. Kështuqë, gjatë muajit dhjetor, ISKK –së i është dashur të veprojë me dy punonjës më pak. Pra nga 19 vetë që pritej të ishte stafi i Institutit gjatë 2019 (duke përfshirë edhe 4 vendet e tjera të punës në protje për miratim), në dhjetor ky staf u rrudh edhe më: në 13 vetë gjithsej.
4. Procesi për amendimin e Ligjit të ISKK, pjesë e të cilit ishte kufizimi i periudhës studimore të këtij Instituti pas nëntorit të vitit 1944, një proces i cili filloi në mes të vitit, bëri që të anulohen ose të zvendësohen projekte të cilat dilnin prej këtij fokusi, duke krijuar edhe vonesa ose moszbatime. Fjala vjen: anulimi i tre botimeve të tilla dhe zëvendësimi i tyre me të tjerë, shtyu pertej limitit të lejuar kohën e tenderimit, duke e bërë të pamundur botimin e tyre për vitit, ndërkohë që librat janë të gatshëm për shtyp.
5. Fushata denigruese kundër ISKK e iniciuar në media nga një deputet i Kuvendit të Shqipërisë, një ish- komandant burgu dhe persona të tjerë në konflikt interesi me ligjin organik të ISKK, solli demoralizimin e bashkëpunëtorëve, stepjen e dëshmitarëve në dhënien e dëshmive audio-vizuale, intimidimin e tyre, deri edhe në humbjen e besimit tek institucionet, tek kauza e transparencës së krimeve të komunizmit në Shqipëri si pjesë e procesit të drejtësisë tranzitore. Kjo është arsyeja që vide-regjistrimet e dëshmive, nuk arritën të kapnin kuotën e parashikuar.
6. Bllokimi i fondeve të pashfrytëzuara për muajin dhjetor për shkak të tërmetit, siç ndodhi edhe me gjithë institucionet e tjera publike.
7. Një tjetër vështirësi vazhdon të mbetet hapësira tejet e kufizuar të ambjenteve të ISKK. Pëveç zyrave që janë jokomode për kushtet e punës së një studjuesi, mungon salla për magazinimin e librave, salla për trajnime apo ëorkshope, salla e leximit apo salla e bibliotekës. Aktualisht, në Institut mungon edhe hapësira për arkivimin e dokumentacionit. I njëjti problem qëndron edhe për arkivimin e objekteve të mbledhura ndër vite për muze.

Por, megjithë numrin tejet të kufizuar të stafit, dhe vështirësive të parashtruara më sipër, ISKK ia doli të hartojë një program pilot arsimor/kulturor, mbi përfshirjen e historisë së komunizmit në

kurrikulën shkollore, dhe të konkurojë me të në përgjigje të thirrjes për grante të vogla të Komisionit European, projekt me të cilin, ISKK u klasifikua në vend të dytë, duke marrë të gjitha pikët për projekt-idenë, por e penalizuar për kapacitetin e vogël financiar në menaxhimin e një granti të tillë. Sidoqoftë, projekti nuk është refuzuar, por është lënë në listën pritjeje për financim gjatë vitit 2020.

Një tjetër aktivitet i paparashikuar dhe i realizuar gjatë vitit 2019, është libri me ilustrime për fëmijë i historisë së Sabiha Kasimatit, i krijuar nga artistja e njohur lituaneze Lina Itagaki. Përfshirjen e menjëhershme të këtij projekti, ne e konsideruam si një mjet shumë të rëndësishëm strategjik për qasjen ndaj shkollave të ciklit nëntëvjeçar, pasi siç e kemi parashtruar edhe në raporte, gjetja e metodologjisë dhe mjeteve efikase të përcjelljes së historisë së komunizmit është një nga aspektet e punës sonë studimore. Libri ka dalë nga shtypi dhe ne në këtë mënyrë, i paraprijmë një fushate në shkolla nëntëvjeçare, bashkë me një ëorkshop për mësuesit e artit dhe historisë, në fillim të 2020.

Më konkretisht, aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2019 sipas rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të lëshuar me datë 27/09/2019, janë:

**• Të vijojë studimin, evidentimin dhe sensibilizimin e publikut ndaj trashëgimisë materiale, e cila dëshmon drejtpërsëdrejti krimet e sistemit komunist si: ish-burgjet, kampet e punës së detyruar dhe kampet e internimit.**

1. Realizimi i konferencës “Menaxhimi i trashëgimisë materiale të komunizmit në Shqipëri”  
- 25 shkurt, 2019

Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri, në bashkëpunim me Fondacionin Konrad Adenauer në Tiranë, organizoi një konferencë shkencore me temë “Manaxhimi i trashëgimisë materiale të komunizmit në Shqipëri”. Konferenca u zhvillua në tre seksione: 1. Panoramë e gjendjes aktuale të trashëgimisë materiale të epokës së komunizmit dhe sensibilizimi publik dhe institucional; 2. Prezantimi dhe shfaqja e filmit dokumentar “Muzeu virtual i Kampit të Tepelenës”, një produksion i ISKK, mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer; 3. Paneli i diskutimit me temën: “Kujtesa materiale: ku, si dhe pse”, në të cilën morën pjesë drejtues të muzeve të kujtesës, kuratorë muzesh, gazetarë, ish- të burgosur politikë dhe studiues të ISKK.

2. Prodhimi i filmit dokumentar në formë video-produksioni “Muzeu virtual i Kampit të Maliqit: pjesa I-rë”

Pas punës kërkimore të ekspertëve të ISKK mbi këtë temë, në bashkëpunim me një kompani produksioni filmik, ISKK arriti të realizojë video-produksionin në 3D “Muzeu virtual i Kampit

të Maliqit, pjesa I”. Por ndryshe nga ç’ ishte parashikuar, konkludimi në tri kampe (Vloçisht, Orman –Pojan dhe Nizhavec) dhe jo dy siç merrej e mirëqenë deri tani, shtoi punën dhe kohën e përmbushjes së projektit. Një tjetër vështirësi e madhe ka të bëjë me improvizimin grafik të terrenit, për shkak të transformimit të tij nga njëra fazë e tharjes së kënetës, në tjetrën, gjë e cila kërkon një kërkim tjetër në arkiva për hartat inxhinierike, të cilat edhe kur gjenden, paraqesin të dhëna të kufizuara.

3. Aktivitet përkujtitor me letërsi dhe muzikë, në ish burgun e Spaçit  
- 29 maj 2019

Në 40 vjetorin e pushkatimit të ish të burgosurve të Spaçit, Xhelal Koprencka, Vangjel Lezho, dhe Fadil Kokomani, në një nga godinat e ish-kampit famëkeq të Spaçit, u realizua një aktivitet përkujtitor me letërsi dhe muzikë. Ky projekt u organizua nga Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë, me mbështetjen e Ambasadës së Austrisë, "Fondacionit Konrad Adenauer" në Tiranë dhe Bashkisë së Rrëshenit. Përveç organizatorëve, merrnin pjesë edhe ish të burgosur të këtij kampi, bashkëvuajtës dhe dëshmitarë të ngjarjeve që u reforehet kjo konferencë. Ligjërimit dhe kumtesave, ia shtua edhe interpretimi i dy instrumentistëve nga Austria: Bertin Christelbauer (violonçel) dhe Zamir Kabo (piano). Qëllimi i këtij aktiviteti, siç u vu në dukje edhe nga ligjëruesit, ishte një apel për t'u vënë fre shkatërrimeve të mëtejshme të trashëgimisë materiale të komunizmit, si pjesë e rëndësishme e kujtesës kolektive.

4. Ekspozita publike fotografike “Shqipëria komuniste: realiteti dhe propaganda”  
- 16 dhjetor, 2019

Përmes një serie fotografish, informacioni të afishuar, dhe elementëve të tjerë të një performace publike, Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri realizoi ekspozitën “Shqipëria komuniste: realiteti dhe propaganda”. Kjo veprimtari synoi përcjelljen e evidencave të persekutimit komunist në Shqipëri dhe të tjetërsimit të realitetit nga propaganda. Ekspozita u materializua me fotografi të vrasjeve në kufi, fotografi të ish të burgosurve politikë të marra në hetuesi dhe burgje; fotografi të klerikëve të burgosur dhe të ekzekutuar; fotografi të fëmijëve në ambasadat e huaja në ngjarjen e 2 korrikut 1990, fotografi qytetarësh të huaj të burgosur në Shqipëri, etj. Në sfond të këtij realiteti, në kontrast të plotë me realitetin, përmes zërit (copëza fjalimesh, kronika televizive, pjesë muzikore nga propaganda e regjimit), u impovizua propaganda komuniste, e cila ishte në kontrast të plotë me atë ka shihej.

- **Të vijojë publikimin e veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist.**



### 1. Përgatitja për shtyp e 16 librave të rinj: botime memuraistike dhe studimore

Drejtorja e Studimeve dhe Arkivës përgatitën për shtyp gjashtëmbëdhjetë botimeve të reja të cilat i përkasin zhanrit të memuareve, studimeve shkencore dhe refleksioneve. Secili prej tyre sjell evidenca të reja ose përvoja personale të cilat mbështesin dokumentacionin ose ngjarjet historike të cilat tashmë janë të njohura dhe të pranura publikisht. Shtrirja kohore dhe tematike e ngjarjeve të trajtuara në këto botime, është mjaft e gjërë dhe e larmishme, ndër të cilat: arrestimet, dënimet me gjyq ose pa gjyq, lufta e klasave, privimi nga të drejtat themelore të shtetasve për shkak të background-t politik, e drejta e fjalës, e drejta e votës, e drejta e pronës, e drejta për arsimim, e drejta për ushtrim profesioni, e drejta për aktivitet publik, etj.

### 2. Realizimi i monografisë dokumentare “Abuzimi me pronën në Shqipërinë komuniste: 1945-1946”

Kjo është monografi dokumentare me fokus abuzimin mbi pronën, reformat komuniste, dhe aktet ilegjitime gjatë periudhës 1945-1946. Seria e dokumenteve që i prezantohet lexuesit është përzgjedhur nga disa fonde të Arkivave të Shtetit Shqiptar që i përkasin Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Bankës së Shtetit, etj dhe reflektojnë abuzimet me pronën në periudhën komuniste. Nëpërmjet letërkëmbimit, qarkoreve, telegrameve, peticioneve etj, del në pah politika e cënimit dhe kufizimit të pronës private dhe centralizimit e kontrollit të ekonomisë nga ana e shtetit, që u sanksionua nëpërmjet ligjeve të konfiskimit, të cilat përfshinë të arratisurit, të burgosurit politikë, pasuritë shtetërore dhe private të vendeve që humbën luftën. U shpronësua shtresa e lartë dhe e mesme e tregtarëve, u shtetëzuan sipërmarrjet private etj. Shteti ndërhyrhyri gjithashtu edhe në notat e transkriptimit të hipotekave, bllokoi pasuritë private pas masës së sekuestrimit dhe ia kaloi përfundimisht shtetit pas konfiskimit.

### 3. “Një jetë për Zotin dhe atdheun”- konferencë - 9 shkurt 2019

Komuniteti katolik shqiptar në bashkëpunim me Institutin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit zhvilluan një konferencë të posaçme për përndjekjen e klerit nga regjimi komunist, duke u fokusuar në figurën e Dom Shtjefën Kurtit, një nga martirët e kishës katolike, meqenëse ISKK, vitin që shkoi botoi edhe një monografi për të. Në panel të diskutimit bënin pjesë përfaqësues të komuniteteve fetare, historianë, teologë, dhe autorët e monografisë.

### 4. Prezantohen 12 botimet e reja të ISKK - 20 shkurt 2019

Me rastin e 28 vjetorit të rrëzimit të statujës së diktatorit Enver Hoxha, ngjarje që shënon simbolikisht rënien e diktaturës në Shqipëri, Instituti për Demokraci, Media & Kulturë

(IDMC) dhe Fondacioni Konrad Adenauer (KAS) në bashkëpunim me ISKK, organizuan në hotel 'Tirana International', konferencën e parë në kuadër të "Ditëve të Kujtesës". Pjesë e rëndësishme e programit, qe edhe prezantimi i 12 botimeve të reja të Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit. Diskutimi pasues u fokusua konkretisht në të ashtuquajturat "grupet armiqësore" në ushtri dhe në përndjekjen e klerit katolik, të mishëruara në këto studime.

5. Homazh poetëve disidentë- takime përkujtimore

- 29 mars 2019

Klubi i Poezisë në Kukës në bashkëpunim me Institutit e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri, bashkë me botimin e një numri special të revistës "Illz", zhvilluan pelegrinazhe në shtëpinë e poetit Vilson Blloshmi dhe Genc Leka në Librazhd, të poetit Havzi Nela në Kukës, dhe të poetit Trifon Xhagjika në Tepelenë. Aktivitetet u shoqëruan me përrurimin e busteve, të projektuara me kontribute të biznesmenëve vendas dhe me lexime ltrare dhe kumtesa.

6. Bisedë me studentët dhe pedagogët e Univesitetit European të Tiranës (UET).

- 3 maj 2019

Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKPK), paraqiti para studentëve pedagogëve të UET kolanën e botimeve vjetore, shkencore e dëshmuere të vitit 2018. Më pas, një sesion diskutimi, përfaqësuesit e këtij Institucioni, paten kënaqesinë t'u përgjigjen pyetjeve të studentëve dhe të pranishmëve.

7. Konferencë përkujtimore me rastin e 46 vjetorit të revoltës së Spaçit

- 21 maj 2019

Meqenëse Revolta e Spaçit përbën një nga pikat kulmore në historinë e qëndresës anti-komuniste (21-23 maj 1973), me rastin e 46 vjetorit të saj, Insitti i Studimeve të Komunizmit në bashkëpunim me forndacionin Kujto.al dhe me shoqatat e Ish të Burgosurve Politikë, organizoi një konferencë në ish burgun e Spacit, në të cilën të mbijeturit e revoltës, risollën edhe njëherë në vemendjen e medias dhe institucioneve këtë ngjarje që dëshmoi jo vetëm natyrën kriminale të atj regjimi, por edhe forcën morale të ish të burgosurve politikë.

8. Tubim përkujtimor në ish burgun e Qafë Barit

- 22 maj 2019

Me rastin e 35 vjetorit të revoltës së Qafë Barit me 22 maj 1984, Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit në bashkëpunim me Fondacionin Kujto.al, organizoi një takim përkujtimor në formë pelegrinazhi në ish kampin- burg të Qafë Barit, ose siç njihej ndryshe

‘Reparti 311’. Në takim folësit risollën torturat dhe gjithë trajtimin mizor që çoi edhe në shpërthimin e revoltës. Me këtë rast u inaugurua edhe një memorial i krijuar në nderim të gjithë shqiptarëve të pafajshëm, të dënuarve politikë që vuajtën dhe vdiqën në këtë kamp. Qëllimi i këtij takimi ishte vetëdijësimi i opinionit publik mbi nevojën e reflektimit mbi krimet e komunizmit, si një element thelbësor i Drejtësisë Tranzitore, në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut dhe demokratizimit të vendit.

9. Bashkëpunim në Konferencën “Fytyra e ‘Armikut të popullit’ gjatë diktaturës së proletariatit në Shqipëri 1944-1990”

- 17 maj 2019

Autoriteti për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Institutin e Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë dhe Muzeun Historik Kombëtar organizuan Konferencën Ndërkombëtare Shkencore: “Fytyra e ‘armikut të popullit’ gjatë diktaturës së proletariatit në Shqipëri 1944-1990”.

10. Pjesëmarrja e ISKK në Panairin e Librit “Tirana 2019”

13-17 nëntor 2019

Në përputhje me misionin e tij dhe pas një aktiviteti disavjeçar studimor, Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, merr pjesë për herë të parë si subjekt më vete në Panairin e Librit “Tirana 2019”, i cili mbahet nga 13 deri me 17 nëntor 2019. Në stendën e ISKK ekspozohen rreth 95 tituj librash dhe revistash, të botuara në një hark kohor prej shtatë vjetësh, në të cilët përfshihen botimet studimore, memualet, botimet me natyrë publicistike dhe krijimtari dhe përkthime nga burgjet dhe kampet e internimit.

11. Konferenca shkencore "Komunizmi dhe feminizmi: format e trajtimit të grave gjatë regjimit komunist në Shqipëri "

- 5,6 dhjetor 2019

ISKK organizoi konferencën shkencore dy-ditore "Komunizmi dhe feminizmi: format e trajtimit të grave gjatë regjimit komunist në Shqipëri " me pjesëmarrjen e gjërë të studjuesve, në të cilën trajtuan tema të cilat lidheshin me këto çështje kryesore: përdorimi i grave si mjet presioni në metodat e Sigurimit të Shtetit dhe raste të abuzimit fizik dhe psikologjik; emancipimi dhe nevoja për fuqi punëtore në industri dhe bujqësi; politikat shtetërore dhe privacia e grave; liria seksuale dhe aborti; divorcet e imponuara; roli i shtetit në planifikimin familjar; dehumanizmi i figurës së nënës; përdorimi i figurës së gruas nga propaganda: në artet figurative, në letërsi, në shtyp, në postera, parrulla, etj. Punimet e konferencës u ndanë në dy

sesione: Sesioni 1: Impakti i luftës së klasave tek gratë shqiptare; Sesioni 2: Propaganda dhe aspekte të tjera të pozitës së gruas në komunizëm

12. Bisedë me studentë të Masterit Shkencor dhe Masterit Profesional në Histori , në Departamentin e Historisë, Universiteti i Tiranës  
- 10 dhjetor 2019

Në sallën Konrad Adenauer të Departamentit të Historisë, u mbajt një bisedë me studentë të Masterit Shkencor dhe Masterit Profesional në Histori mbi “Kampin e Tepelenës dhe dëshmitë e të mbijetuarve të tij” nga një përfaqësues i ISKK. Biseda u zhvillua në kuadër të lëndës ‘Historia dhe Kujtesa’, me fokus periudhën komuniste në Shqipëri. Dr. Enriketa (Pandelejmoni) Papa, duke prezantuar të ftuarën para audiencës, bëri edhe një rezymë të punës së ISKK në mbledhjen e dëshmive. Studentët ndoqën një film në 3D në formën e një muzeu virtual mbi Kampin e Tepelenës, të realizuar nga ISKK. Pas kësaj, u fol mbi përvojën në marrjen e dëshmive të të mbijetuarve si pjesë e kolanës “Zërat e kujtesës” të botuar nga ky Institut, për rolin e dëshmisë në mungesë të dokumentacionit, për metodologjinë dhe teknikat e intervistimit, dhe për trajtimin e dëshmisë mbi kritere shkencore si edhe mbi aspektin psikologjik të marrjes së dëshmive, duke e ilustruar bisedën me shembuj konkretë. Më pas, e ftuara iu përgjigj pyetjeve të shumta të studentëve lidhur me të shkuarën komuniste.

• **Te studioje mekanizmat që u perdoren nga organet shteterore dhe partiake per te krijuar hendekun ndermjet kundershareve politike reale apo potenciale me pjesen tjetër te popullsisë.**

1. Përgatitja dhe botimi i “Fjalor enciklopedik i vikimitave të terrorit komunist”,  
Vëllimi VIII (Gërmat ‘Sh’, ‘T’, ‘Th’, ‘U’, ‘V’)

Është përgatitur për shtyp, vëllimi i VIII-të i këtij fjalori enciklopedik, i cili përfshin të gjitha format e dënimeve politike (ekzekutim, burgim, internim dhe dëbim), argumentimin ligjor dhe kohën e vuajtjes së dënimit. Puna u zhvillua në dy faza: përzgjedhja e dokumenteve përkatëse për vëllimin nga grupi i përgjithshëm i dokumenteve, radhitja, verifikimi, plotësimi, redaktimi, dhe faqosja. Ky botim projektonte më së miri mekanizmin e fabrikimit të elementit ‘armik’, instrumentalizimin e ligjit, dënimin për faje të pakryera, dhe përdorimi i tyre si mjete presioni ndaj pjesës tjetër të popullsisë.

2. Përgatitja për shtyp e monografisë “Nikollë Dakaj, mes perktimit dhe proceseve politike”

Siç është parashikuar edhe në planin vjetor, ka përfunduar përgatitja e monografisë “Nikollë Dakaj, mes perkthimit dhe proceseve politike”, që përben edhe vëllimin e VI-të të serisë së botimeve “Akte gjyqësore politike gjatë komunizmit në Shqipëri”.

### 3. Përgatitja për shtyp dhe botimi i librit me ilustrime për fëmijë mbi jetën e Sabiha Kasimatit

Një grup i ISKK gjatë periudhës tetor-dhejtor bashkëpunoi me artisten lituaneze Lina Itagaki për hartimin e një libri me ilustrime mbi jetën e Sabiha Kasimatit, shkencëtares së ekzekutuar nga regjimi komunist, të përshtatur për shkollat tetëvjeçare, kryesisht grupmoshën 10-12 vjeç. Gjatë këtij procesi, asaj iu ofrua konsulencë dhe dokumentacion, dhe me ndihmën e Fondacionit Konrad Adenauer është realizuar një workshop dy-ditor me të në Tiranë dhe Korçë, që ishte edhe qyteti i Sabihasë. Historia ilustruese është bazuar në një tregim rreth jetës së Sabiha Kasimatit, e shkruar nga Agron Tufa, ish-drejtor ekzekutiv i ISKK, dhe Luljeta Lleshanaku, drejtore e studimeve në ISKK, kontribuoi si konsulente dhe përkthyes e tekstit të librit.

#### **• Të hulumtojë mbi format e rezistencës morale dhe kulturore nëpër burgje apo kampe përqendrimi, si dhe shtypjen e ndëshkimit që i pasoi.**

1. Realizimi i 30 orëve video-regjistrime me të dëshmitarët të mbijetuarve nga burgjet dhe kampet në Shqipërinë Komuniste.

Ky aktivitet është pjesë e projektit afatgjatë të krijimit të arkivës audio-vizuale të dëshmitarëve të ish- të përndjekurve politikë. Për arsye që përmendëm më sipër, deri tani janë realizuar 30 orë dëshmish të regjistruara, nga 60 orë të planifikuara për këtë vit.

#### **• Të evidentojë rolin që media dhe gazetaria shqiptare ka pasur gjatë periudhës postkomuniste në nxitjen e ndjeshmerisë publike dhe reflektimin shoqëror ndaj se kaluarës së vendit.**

1. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2019, Drejtoria e Arkivës dhe ajo e Studimeve, ka filluar punën kërkimore dhe grumbulluese të ekzemplarëve të shtypit të periudhës post-komuniste. Konkretisht, kemi arritur të mbledhim pjesën më të madhe të koleksionit të gazetës “Liria”.
2. Përtej këtij rekomandimi, për qëllime studimore janë mbledhur edhe koleksione që i përkasin periudhës para vitit 1991, siç janë: koleksioni i revistës “Në Shërbim të Popullit”, koleksione të gazetës “Zëri i Poullit”, “Zëri i Rinisë”, “Bashkimi” dhe të revistës “Hosteni”. Paralelisht me procesin e mbledhjes, po punohet për hartimin e një vëllimi me karikatura të kohës, lidhur me kontekstin e tyre propagandistik.

- **Të bashkëpunojë me televizionet kombëtare, për të ekspozuar punën studimore të Institutit, duke krijuar një hapësirë të dedikuar televizive, me qëllim informimin publik mbi të shkuarën komuniste të vendit.**

Bashkëpunimi me median televizive, në formën e kronikave televizive, intervistave dhe debateve në studio, ka qenë mjaft i ngjeshur gjatë vitit 2019. Përmbledhtas, listojmë:

31 janar 2019: Channel one; 21 shkurt 2019: Report TV; 25 shkurt 2019: Zëri i Amerikës; 12 mars, 2019 : Top Channel, Emisioni “Top show”; 21 prill 2019: Ora Neës, Emisioni i Pasdites; 4 shkurt 2019: FAX WEB TV; 21 prill 2019 - Intervistë në Ora News, emisioni mbasdites; 23 prill 2019 - Top Channel , Top Shoë; 26 prill 2019 - Fax News Intervistë; 6 maj 2019: Vizion PLUS, Programi “Real story”; 24 prill, 2019 Top Channel: Top Talk show; 30 prill 2019, ABC neës: programi “Provokacija”; 6 maj 2019: NEËS 24: “A Show”; 7 maj 2019, TOP CHANNEL” “Top show”; 26 qershor 2019: Deutsche Welle; 8 maj 2019: A2 TV; 5 Nëntor 2019: Top Shoë, TOP CHANNEL; 5 dhjetor 2019: A1TV (kronikë); 5 dhjetor 2019: ABC news (kronikë); 11 dhjetor 2019: Opinion TV KLAN.; 16 dhjetor 2019: ABC News (kronikë); 16 dhjetor 2019: A1TV (kronikë), etj..

- **Të forcojë aksesin publik *online* mbi të gjithë veprimtarinë e Institutit, të intensifikojë fushatat e ndërgjegjesimit, duke përdorur gjerësisht rrjetet sociale, lehtësisht të arritshme, sidomos në brezat e periudhës post '90.**

1. Me realizimin e Muzeut të parë dixhital, që qe ai i Ish kampit të Tepelenës, ne krijuam mundësinë e një aksesit më të gjërë publik. Edhe filmi i dytë që është në process, që është muzeu dixhital i Kampit të Maliqit, gjithashtu do të publikohet në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale. Përdorimi dinamik i facebook-ut, ka shërbyer për mbajtjen në kontakt publikun me të rejtat e fundit, përfshirë këtu edhe publikimin e herëpashershëm të dokumunteve që janë shumë domethënës veçanërisht për brezin e ri. Nga ana tjetër, aktivitetet në bashkëpunim me Institucionet e tjera si me IDMC, Kujto.al dhe institucione të tjera, mundësojnë shpërndarjen e informacionit nga burime paralele, duke sjellë edhe zgjerimin e aksesit publik në të njejtën kohë.

- **Përmes forcimit të kapaciteteve shkencore dhe studimore të punonjësve të tij Instituti, të rrisë standardet e botimeve dhe studimeve, duke shmangur interpretimet e njëanshme të ngjarjeve dhe fakteve historike.**

- Në të dyja konferencat shkencore që realizoi ISKK gjatë vitit që shkoi, siç parashtrohet edhe në programin e tyre, është sigurur pesëmarrja e mendimit shkencor të institucioneve të tjera akademike, si historianëve, sociologëve nga katedra dhe universitete të ndryshme dhe e gazetarëve nga mediat e huaja dhe të pavarura në vend. Nxitja e debatit shkencor nga këndvështrime të ndryshme, i ka shërbyer objektivitetit të trajtimin të temës delikate të komunizmit, po aq sa edhe ka zgjeruar bashkëpunimin dhe interesin akademik për produktin e këtij Instituti.
- Përgatitja e një platforme edukimi të periudhës komuniste në shkolla, në formën e një projekti pilot për të cilin është aplikuar në Zyrën e Komisionit Evropian, edhe pse është akoma në fazë pritjeje, nënkupton përfshirjen e një rrjeti të gjërë studjuesish dhe ekspertësh nga institucionet e tjera akademike në vend për hartimin e teksteve dhe programeve shkollore, po aq sa edhe të strategjisë dhe modelit pedagogjik të aplikimit të tij.
- Lidhur me aktivitetet studimore, kohët e fundit është zgjeruar rrethi i bashkëpunimit të studjuesve të ISKK me arkivistë, profesorë të universitetit dhe me institucione që merren me zbardhjen e historisë së Komunizmit. Ndërkohë, për forcimin e kapaciteteve të brendshme dhe profesionalizmit, brenda katër muajve të fundit, për projekte të ndryshme, ISKK ka kontraktuar me kohë të pjesshme 5 ekspertë të jashtëm, si: në fushën e kërkimeve historike dhe gazetarisë, video-produksionit, ligjit, dhe financave.

Një hap tjetër drejt shmangies së çdo lloj interpretimi të njëanshëm, është që të gjitha botimet e ISKK, i janë nënshtuar një ekspertize të hollësishme dhe të dyfishtë, nga bordi ekzekutiv dhe nga Këshilli Shkencor. Ndërsa Bordi Ekzekutiv është kujdesur për respektimin e ligjit në përmbajtjen e tyre, bordi shkencor, me recencat e veta, është kujdesur për seleksionim e veprave edhe në nivelin profesional dhe në rëndësinë që paraqet secila prej tyre në informimin publik dhe sidomos edukimin e brezit të ri.

**• Të propozojë ndryshimet e duhura ligjore, të cilat sjellin përmirësimin e punës në arkivin e Institutit, në përcaktimin e detyrimit ligjor për pajisjen me "çertifikatë sigurie" për punonjësit që punojnë me dokumentet arkivore brenda dhe jashtë tij, me përcaktimin e qartë ligjor në Shqipëri, si dhe me specifikimet që lidhen me kualifikimet shkencore të domosdoshme (tituj dhe grada shkencore), që duhet të kenë punonjësit e Institutit që merren me studime dhe botime.**

Pas resolutës së miratuar me datë 27 maj 2019, së cilës i referohet edhe ky raport, nga një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë është propozuar një amendim i Ligjit, ose më saktë disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.10242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", konkretisht ndryshim i

Nenit 3, shkronja 1, mbi përcaktimin e "periudhes se sistemit komunist" dhe i nenit 18, pika 1, që përveç të tjerash ka të bëjë edhe me pajisjen me Çertifikatën e Sigurimit të Personelit nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

I informuar mbi këtë nismë mbi amendimin e Ligjit, ISKK i dërgon një kërkesë të detajuar Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit të Ligjeve, dhe për dijeni institucioneve të tjera politike, në të cilën paraqitën argumentet ligjore që bien ndesh me disa ndryshime të propozuara nga ky komision, midis të cilave edhe pajisja me çertifikatën e Sigurimit të Informacionit.

Pas një debati të zhvilluar në Komisionin e Ligjeve me datë 26 korrik 2019 mbi këtë çështje, seancë në të cilën ishte i ftuar edhe Drejtori Ekzekutiv i ISKK, u miratua ndryshimi i Nenit 3, lidhur me përcaktimin e "periudhes se sistemit komunist" që është edhe objekti i studimit të ISKK, dhe nuk u miratua ndryshimi i Neni 18, në të cilin bën pjesë edhe pajisja me Çertifikatën e Sigurimit të Informacionit. Megjithatë, edhe votimi i këtij amendimi të pjesshëm të ligjit në Kuvendin e Shqipërisë i cili ishte planifikuar në seancën e fundit parlamentare në muajin korrik, u anulua, dhe nuk është zhvilluar akoma. Kështuqë, gjithsesi, kjo pikë e rezolutës mbetet jashtë detyrimeve tona si Institucion.



### iii. KONKLUSIONE

Pra, gjatë vitit 2019, veprimtaria e ISKK konsistoi në:

- Sensibilizimin publik dhe institucional mbi trashëgiminë materiale të periudhës komuniste dhe rëndësinë e saj
- Vitalizimin e kësaj trashëgimie materiale përmes dokumenimit filmik dhe teknikave dixhitale dhe ekspozitës
- Evidentimin e rasteve të reja të persekutimit, dënimeve me burg dhe internim, përmes zgjerimit të databases dhe numrit të ri të Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Komunizmit
- Evidentimin e dhunës fizike dhe psikologjike në hetuesi dhe burgje, përmes dëshmive të të mbijetuarve
- Interpretimin e marrëdhënieve gjinore dhe të statusit real të gruas në shtetin komunist, në kontekstin e luftës së klasave dhe propagandës
- Hartimin e një strategjie të re edukimi për përfshirjen e historisë së komunizmit në shkolla, përmes një projekti pilot, të gjërë dhe multi-disiplinor
- Prodhimin e mjeteve didaktike, si një qasje e re ndaj nxënësve të shkollave
- Informimin dhe analizimin e procesit të reformave komuniste mbi pronën, në vitet 1945-1946
- Evidentimin e rasteve të rezistencës morale dhe fizike në burgje dhe kampet e punës përmes konferencave promemorie dhe botimeve
- Evidentimin e rolit absolut të medias si mjet propagande në shtetin komunist
- Analizimin e marrëdhënies armiqësore të shtetit komunist me klerin
- Sensibilizimin e komuniteteve të artistëve lidhur me dramën e komunizmit

- Evidentimin e akteve të dhunës dhe keqtrajtimit të të burgosurve politikë në kampin e punës së Maliqit; shfrytëzimi i të burgosurve politikë si krahë pune
- Identifikimin e viktimave të reja si pasojë e dhunës në kampet e punës
- Zgjerimin e hartës së veprave të ndërtuara me punën e të burgosurve politikë përmes dokumenteve dhe dëshmimeve
- Evidentimin e akteve të paligjshme të ish Sigurimit të Shtetit, në rekrutimin e informatorëve nën presion, dhe në trajtimin në hetuesi
- Evidentimin e rasteve të reja të ekzekutimeve në kufi
- Zgjerimin e aksesit publik të ISKK përmes debateve mediatike dhe performancës publike
- Forcimin e partneritetit ndërkombëtar me institucione homologe të huaja
- Ndërkombëtarimin e historisë së komunizmit në Shqipëri përmes bashkëpunimit me artistë të huaj në projekte të veçanta
- Zgjerimin e marrëdhënieve me institucionet akademike dhe organizatave të tjera brenda vendit

## II. AKTIVITETET

### 1. KONFERENCA

#### 1.1 Konferenca të organizuara nga ISKK

##### 1.1.1

TITULLI PROJEKTIT	I	<b>“Menaxhimi i trashëgimisë materiale të komunizmit në Shqipëri”</b> <i>Konferencë shkencore</i>
KOHA REALIZIMIT	E	25 shkurt, 2019
PËRMBAJTJA		<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Në këtë konferencë një-ditore, përmes ligjëratave dhe tryezës së diskutimit, u analizua gjendja e trashëgimisë materiale të periudhës komuniste në Shqipëri, u argumentua rëndësia e ruajtjes dhe vitalizimit të kësaj trashëgimie në kontekstin historik dhe edukativ, dhe u hodhën ide bashkëpunimi midis institucioneve kërkimore, institucioneve muzeale, pushtetit lokal, studjuesve &amp; antropologëve, ish-të përndjekurve politikë, shkollave dhe shoqatave të ndryshme në vend.</p> <p>Kjo konferencë u realizua nga Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri, në bashkëpunim me Fondacionin Konrad Adenauer në Tiranë, në të cilën merrnin pjesë studjues, menaxherë dhe kuratorë muzesh, ish të përndjekur politikë, dhe individë që sollën përvojën e tyre në koleksionimin dhe publikimin e materialeve vizuale dhe fizike që simbolizojnë këtë periudhë. Konferenca u zhvillua në tre sesione: 1. Panoramë e gjendjes aktuale të trashëgimisë materiale të epokës së komunizmit dhe sensibilizimi publik dhe institucional; 2. Prezantimi dhe shfaqja e filmit dokumentar “Muzeu virtual i Kampit të Tepelenës”, një produksion i ISKK, mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer; 3. Paneli i diskutimit me temën: “Kujtesa materiale: ku, si dhe pse”, në të cilën morën pjesë drejtues të muzeve të kujtesës, kuratorë muzesh, gazetarë, ish-të burgosur politikë dhe studiues të ISKK.</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p>

	<p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;</i>  <i>h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri;</i>  <i>i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit.</i></p> <p><u>Qëllimi i projektit</u></p> <p>Sensibilizimi institucional dhe public mbi domosdoshmërinë e ruajtjes dhe vitalizimit të trashëgimisë material të komunizmit në Shqipëri.</p> <p><u>Ligjërues në konferencë:</u> Agron Tufa, Drejtori Ekzekutiv i ISKK; Walter Glos, Drejtor i Fondacionit Konrad Adenauer në Tiranë (KAS); Luljeta Lleshanaku, Drejtore e Studimit të ISKK dhe skenariste e filmit dokumentar "Muzeu Virtual i Kampit të Tepelenës"; Elton Baxhaku &amp; Klit Burda – autorë të filmit dokumentar në 3D "Muzeu Virtual i Kampit të Tepelenës"; Bedri Çoku, ish i burgosur dhe Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve (1994-1998); Admirina Peçi, gazetare, studiuese e muzeve "Bunk'Art"; Etleva Demollari, drejtore e Musem “Shtëpia e gjetheve”; Pjerin Mirdita, ekspert, i Muzeut "Vendi i dëshmitarit dhe kujtesës" në Shkodër; Elektra Çapaliku, autore e librit "Magazina e komunizmit shqiptar"</p>
PARTNERË	<p>Fondacioni Konrad Adenauer në Tiranë          Muzeu “Shtëpia e gjetheve”, Tiranë          Muzeu "Vendi i dëshmisë dhe kujtesës”, Shkodër</p>

### 1.1.2

TITULLI PROJEKTIT	I <b>"Komunizmi dhe feminizmi: format e trajtimit të grave gjatë regjimit komunist në Shqipëri"</b> <i>Konferencë shkencore</i>
KOHA REALIZIMIT	E 5-6 dhjetor 2019

## PËRMBAJTJA

### Përshkrimi i projektit

Konferenca "Komunizmi dhe feminizmi: format e trajtimit të grave gjatë regjimit komunist në Shqipëri" ishte një konferencë dy-ditore e mbajtur në Tiranë, me objekt trajtimin e gruas në komunizëm, në kontekst të respektimit të të drejtave të njeriut, luftës së klasave, propagandës në Shqipërinë komuniste si edhe në kontekst me proceset sociale në ish vendet e tjera komuniste dhe në perëndim. Me pjesëmarrjen e gjërë të studjuesve, në konferencë u trajtuan tema të cilat lidheshin me këto çështje kryesore: përdorimi i grave si mjet presioni në metodat e Sigurimit të Shtetit dhe rastet e abuzimit fizik dhe psikologjik; emancipimi dhe nevoja për fuqi punëtore në industri dhe bujqësi; politikat shtetërore dhe privacia e grave; liria seksuale dhe aborti; divorcet e imponuara; roli i shtetit në planifikimin familjar; dehumanizmi i figurës së nënës; përdorimi i figurës së gruas nga propaganda: në artet figurative, në letërsi, në shtyp, në postera, parrulla, etj.

Punimet e konferencës u ndanë në dy sesione: Sesioni 1: Impakti i luftës së klasave tek gratë shqiptare; Sesioni 2: Propaganda dhe aspekte të tjera të pozitës së gruas në komunizëm:

Konkretisht, ligjërat e paraqitura në këtë konferencë janë:

Dr. Enriketa Papa: "Kujtesa për gulagët shqiptarë dhe gratë: Histori vuajtjesh dhe mbijetese në Shqipërinë komuniste"

Dr. Lindita Arapi, Gazetare në 'Deutsche Welle: "Ngrëhina e frikës – tentativa për deformimin e personalitetit të gruas në vitet e diktaturës"

Admirina Peçi, Gazetare dhe kërkuese e Muzeut "Bunk'Art" : "Tortura ndaj femrave të burgosura në regjimin komunist, dëshmi dhe dokumente"

Dr. Çelo Hoxha: "Orientimi politik për rritjen e lindshmërisë dhe rritja e padëshiruar e aborteve"

Msc.Florin Zyberaj: "Gruaja shqiptare, e emancipuar apo e nënshtruar: retrospektivë nga regjimi komunist"

Dr. Klejdi Këlliçi/ Dr. Ermira Danaj: "Emancipimi si sakrifice: i gjithë populli ushtar"

Mirela Muça, Drejtuese e Qendrës për Studime Sociale: "Roli i shtetit në planifikimin familjar"

Dr. Irida Vorpsi: "Revista Shqiptarja e re si përçuese e propagandës së PPSH"

Luljeta Lleshanaku, Drejtore Studimeve në ISKK: "Feminizmi socialist: premtimi i lirisë seksuale dhe ekonomike për gratë"

	<p>Msc. Ervisa Zaja: “Skicimi e figurës së nënës gjatë periudhës së diktaturës”</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;</i></p> <p><i>ë) evidenton personat, që kanë qenë pjesë e organeve apo autoriteteve vendimmarrëse, përgjegjëse për propagandën komuniste, për aktet administrative dhe vendimet, të cilat kanë çuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, në veprime represioni, në jetën shoqërore dhe kulturore, përfshirë luftën e klasave, kolektivizimin, luftën kundër fesë, izolimin nga Perëndimi, pamundësinë për t'u informuar dhe censurën në art, kulturë e shkencë, si dhe kufizimin e furnizimit me ushqime, përmes tallonave të ushqimit;</i></p> <p><i>e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit së Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist; i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit.</i></p> <p><u>Qëllimi i projektit</u></p> <p>Informimi me objektivitet mbi gjendjen e të drejtave civile në Shqipëri gjatë regjimit totalitar, duke u fokusuar në të drejtat dhe liritë e grave.</p>
PARTNERË	Fondacionit Konrad Adenauer në Tiranë Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë

### 1.1.3

TITULLI PROJEKTIT	I <b>Konferencë përkujtimore me rastin e 46 vjetorit të revoltës së Spaçit</b>
KOHA REALIZIMIT	E 21 maj, 2019

PËRMBAJTJA	<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Meqenëse Revolta e Spaçit përbën një nga pikat kulmore në historinë e qëndresës anti-komuniste (21-23 maj 1973), me rastin e 46 vjetorit të saj, Insitti i Studimeve të Komunizmit në bashkëpunim me forndacionin Kujto.al dhe me shoqatat e Ish të Burgosurve Politikë në rrethe, organizoi një konferencë në ish burgun e Spacit, në të cilën të mbijeturit e revoltës, risollën edhe njëherë në vemendjen e medias dhe institucioneve këtë ngjarje që dëshmoi jo vetëm natyrën kriminale të atj regjimi, por edhe forcën morale të ish të burgosurve politikë.</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>b) analizon, studion dhe dokumenton krimet e kryera nga organet e diktaturës komuniste, si dhe pasojat gjatë dhe pas periudhës së komunizmit; c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;</i></p> <p><i>ç) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;</i></p> <p><u>Qëllimi i projektit</u></p> <p>Të informojë publikun dhe të mbaje të gjallë kujtesën kolektive mbi natyrën kriminale të sistemit komunist.</p>
PARTNERË	Shoqatat e Ish të Përndjekurve Politikë në qendër dhe rrethe

#### 1.1.4

TITULLI PROJEKTIT	I <b>Tubim përkujtimor në ish burgun e Qafë Barit</b>
KOHA REALIZIMIT	E 22 maj, 2019

PËRMBAJTJA	<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Me rastin e 35 vjetorit të revoltës së Qafë Barit me 22 maj 1984, Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit në bashkëpunim me Fondacionin Kujto.al, organizoi një takim përkujtimor në formë pelegrinazhi në ish kampin- burg të Qafë Barit, ose siç njihet ndryshe ‘Reparti 311’. Në takim folësit risollën torturat dhe gjithë trajtimin mizor që çoi edhe në shpërthimin e revoltës. Me këtë rast u inaugurua edhe një memorial i krijuar në nderim të gjithë shqiptarëve të pafajshëm, të dënuarve politikë që vuajtën dhe vdiqën në këtë kamp. Gjatë tubimit, ish vuajtësit në këtë kamp-burg, risollën në kujtesë disa nga momentet më dramatike të revoltës, figurat e përfshira në revoltë dhe pasojat e saj, si edhe shtruan edhe njëherë nevojën e reflektimit mbi krimet e komunizmit, si një element thelbësor i Drejtësisë Tranzitore, në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut dhe demokratizimit të vendit.</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;</i></p> <p><i>ç) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;</i></p> <p><i>h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri.</i></p> <p><u>Qëllimi i projektit</u></p> <p>Informimi mbi burgjet, kampet e punës, format e rezistencës politike në komunizëm, si edhe sensibilizimi mbi ruajtjen e dëshmimeve materiale të kësaj periudhe si formë e memories kolektive.</p>
PARTNERË	Fondacioni Kujto.al Shoqatat e Ish të Përndjekurve Politikë



## 1.2 Bashkëpunime

### 1.2.1

TITULLI PROJEKTIT	I	<b>Aktivitet përkujtivor me letërsi dhe muzikë, në ish burgun e Spaçit</b>
KOHA REALIZIMIT	E	29 maj, 2019
PËRMBAJTJA		<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Në 40 vjetorin e pushkatimit të ish të burgosurve të Spaçit, Xhelal Koprencka, Vangjel Lezho, dhe Fadil Kokomani, në një nga godinat e ish-kampit famëkeq të Spaçit, u realizua një aktivitet përkujtivor me letërsi dhe muzikë. Ky projekt u organizua nga Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë, me mbështetjen e Ambasadës së Austrisë, "Fondacionit Konrad Adenauer" në Tiranë dhe Bashkisë së Rrëshenit. Përveç organizatorëve, merrnin pjesë edhe ish të burgosur të këtij kampi, bashkëvuajtës dhe dëshmitarë të ngjarjeve që u reforehet kjo konferencë. Bisedave dhe kumtesave, ia shtua edhe interpretimi i dy instrumentistëve nga Austria: Bertin Christelbauer (violonçel) dhe Zamir Kabo (piano). Në fjalën e tyre, ligjëruesit jo vetëm që risollën në vëmendje historinë e këtij kampi, vuajtjet dhe aktet barbare të shtetit dhe komandës së burgut, por edhe bënë një një apel për t'u vënë fre shkatërrimeve të mëtejshme të trashëgimisë materiale të komunizmit, si pjesë e rëndësishme e kujtesës kolektive.</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me dtyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për "Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;</i></p> <p><i>ç) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;</i></p>

	<p><i>h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri.</i></p> <p><u>Qëllimi i projektit</u></p> <p>Informimi mbi burgjet, kampet e punës, format e rezistencës politike në komunizëm, si edhe sensibilizimi mbi ruajtjen e dëshmive materiale të kësaj periudhe si formë e memories kolektive.</p>
PARTNERË	<p>Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë Ambasadës e Austrisë, Fondacionit Konrad Adenauer Bashkia e Rrëshenit.</p>

### 1.2.2

TITULLI PROJEKTIT	I	“Një jetë për Zotin dhe atdheun”
KOHA REALIZIMIT	E	9 shkurt, 2019
PËRMBAJTJA		<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Komuniteti katolik shqiptar në bashkëpunim me Institutin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit zhvilluan një konferencë të posaçme për përndjekjen e klerit nga regjimi komunist, duke u fokusuar në figurën e Dom Shtjefën Kurtit, një nga martirët e kishës katolike, bazuar mbi monografinë që ISKK botoi vitin që shkoi mbi këtë figurë. Në panel të diskutimit bënë pjesë përfaqësues të komuniteteve fetare, historianë, teologë, dhe autorët e monografisë.</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>ë) evidenton personat, që kanë qenë pjesë e organeve apo autoriteteve vendimmarrëse, përgjegjëse për propagandën komuniste, për aktet administrative dhe vendimet, të cilat kanë çuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, në veprime represioni, në jetën shoqërore dhe</i></p>

	<p><i>kulturore, përfshirë luftën e klasave, kolektivizimin, luftën kundër fesë, izolimin nga Perëndimi, pamundësinë për t'u informuar dhe censurën në art, kulturë e shkencë, si dhe kufizimin e furnizimit me ushqime, përmes tallonave të ushqimit;</i></p> <p><i>h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri.</i></p> <p><u>Qëllimi i projektit</u></p> <p>Të informojë publikun mbi asgjësimin e fesë dhe persekutimin ndaj klerit të shtetit komunist, si edhe shkaqe dhe pasojat e këtij procesi tek individët dhe në shoqërinë Shqiptare në përgjithësi.</p>
PARTNERË	<p>Institucionet fetare</p> <p>Shoqatat e Ish të Përndjekurve Politikë</p>

### 1.2.3

TITULLI PROJEKTIT	I	<p><b>“Ditët e Kujtesës”</b></p> <p><i>Konferencë e organizuar nga IDMC</i></p>
KOHA REALIZIMIT	E	20 shkurt, 2019
PËRMBAJTJA		<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Me rastin e 28 vjetorit të rrëzimit të statujës së diktatorit Enver Hoxha, ngjarje që shënon simbolikisht rënien e diktaturës në Shqipëri, Instituti për Demokraci, Media &amp; Kulturë (IDMC) dhe Fondacioni Konrad Adenauer (KAS) në bashkëpunim me ISKK, organizuan në hotel ‘Tirana International’, konferencën e parë në kuadër të “Ditëve të Kujtesës”. Në pjesën e parë të konferencës, u mbajt ligjërata “Shqipëria dhe Rënia e Komunizmit në Europën Lindore” nga historiani Bernd Fischer. Fjala e zotit Fischer, u pasua nga një diskutim i moderuar nga Gentiana Kera.</p> <p>Në pjesën e dytë, të titulluar “Prezantim i librave mbi diktaturën”, u prezantua edhe libri “Mes Apatisë dhe Nostalgjisë”, botim i IDMC, dhe 12 botimet e reja të ISKK. Fillimisht, z.Tufa bëri një rezymë të secilit prej librave, duke theksuar edhe rolin e rëndësishëm të dëshmisë, meqenëse pjesa dominuese e këtij seti botimesh i përkasin natyrës së memuarit dhe ditareve. Pastaj u ndal konkretisht në botimet studimore, në të ashtuquajturat “grupet armiqësore” në</p>

	<p>ushtri dhe në përndjekjen e klerit katolik, të mishëruara në këto studime. Përmes një performace mbresëlënëse të aktores Egla Cena, u interpretuan pjesë nga gjithë librat, dhe në fund, iu dha fjala të pranishmëve në sallë.</p> <p><u>Ligjërues në konferencë:</u> Jonila Godole, Drejtore e IDMC; Walter Glos, Drejtor i KAS; Karol Bachura, Ambasador i Republikës së Polonisë në Tiranë, Agron Tufa, drejtor i ISKK; Bernd Fischer. Historian; Gentiana Kera, historian; Irit Idrizi, studjues, Univesiteti i Vienës.</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;</i></p> <p><i>g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;</i></p> <p><i>h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat etij në Shqipëri;</i></p> <p><i>i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;</i></p> <p><u>Qëllimi i projektit</u></p> <p>Informimi përmes botimit dhe performancës publike mbi aspekte të ndryshme të realitetit komunist në Shqipëri dhe sensibilizimi publik.</p>
PARTNERË	<p>Instituti për Demokraci, Media &amp; Kulturë (IDMC) Fondacioni Konrad Adenauer (KAS)</p>

#### 1.2.4

TITULLI PROJEKTIT	I	<b>Homazh poetëve disidentë</b> <i>Takime përkujtimore</i>
KOHA REALIZIMIT	E	29 mars, 2019

PËRMBAJTJA	<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Klubi i Poezisë në Kukës në bashkëpunim me Institutin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri, bashkë me botimin e një numri special të revistës “Illz”, zhvilluan pelegrinazhe në shtëpinë e poetit Vilson Blloshmi dhe Genc Leka në Librazhd, të poetit Havzi Nela në Kukës, dhe të poetit Trifon Xhagjika në Tepelenë. Aktivitetet u shoqëruan me përrurimin e busteve, të projektuara me kontribute të biznesmenëve vendas dhe me lexime letrare dhe kumtesa.</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat etij në Shqipëri;</i></p> <p><i>i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit.</i></p>
PARTNERË	Bashkia Kukës Revista “Illz”

### 1.2.5

TITULLI PROJEKTIT	I “Fytyra e ‘armikut të popullit’ gjatë diktaturës së proletariatit në Shqipëri (1944-1990)” <i>Konferencë e organizuar nga AIDSSH</i>
KOHA REALIZIMIT	E 17 maj, 2019

<p>PËRMBAJTJA</p>	<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Autoriteti për informim mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Muzeun Historik Kombëtar realizoi konferencën “Fytyra e ‘armikut të popullit’ gjatë diktaturës së proletariatit në Shqipëri (1944-1990)”. Aspektet kryesore të trajtuara në këtë konferencë, ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Diskutim teorik mbi konceptet disidencë, disident, kundërshtar politik.</li> <li>2. A ka pasur disidencë në Shqipëri?</li> <li>3. Ngjashmëri dhe dallime në vizatimin e “armikut të popullit” midis Shqipërisë dhe regjimeve të tjera komuniste të Evropës Lindore e Qendrore.</li> <li>4. Tipologjia e “armikut të popullit” dhe sjelljes së regjimit ndaj tyre (“kriminelët e luftës”, kleri, intelektualët e shkolluar në Perëndim, tregtarët dhe pronarët, kulakët, “armiku i popullit” brenda radhëve të Frontit Demokratik dhe PKSH/PPSH).</li> <li>5. Evolucionin e konceptit “armik i popullit” gjatë viteve të diktaturës së proletariatit.</li> <li>6. Lufta e klasave dhe ndryshimet në konceptimin e saj përgjatë regjimit.</li> <li>7. Sigurimi i Shtetit si instrument përndjekjeje.</li> <li>8. Profile të ndryshme të “armikut të popullit”.</li> </ol> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat etij në Shqipëri;</i></p> <p><i>i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit.</i></p>
-------------------	---

## 1.2.6

TITULLI PROJEKTIT	I <b>Pjesëmarrje në Mbledhjen e 9-të Vjetore të Këshillit të Anëtarëve të Platformës së Kujtesës dhe Ndërgjegjes Europiane (PEMC)</b>  <i>Konferencë e organizuar nga IDMC</i>
KOHA REALIZIMIT	E 3-6 nëntor 2019
PËRMBAJTJA	<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Delegacioni i Platformës së Kujtesës dhe Ndërgjegjes Europiane (PEMC) vizitoi Shqipërinë më datat 3-6 nëntor 2019, në kuadër të Mbledhjes së 9-të Vjetore të Këshillit të Anëtarëve, organizuar në bashkëpunim me Institutin për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC), që është anëtar i Platformës prej vitit 2016. Ky takim i ofroi mundësinë 50 përfaqësuesve ndërkombëtarë, aktorë të ndryshëm që punojnë në fushën e ballafaqimit me të shkuarën ndër të cilët tashmë bën pjesë edhe ISKK, të vizitojnë vendet të ndryshme të kujtesës në Tiranë, Shkodër dhe Lezhë.</p> <p>Qëllimi kryesor i Platformës është të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për historinë evropiane dhe krimet e kryera nga regjimet totalitare dhe për të inkurajuar një diskutim të gjerë evropian për shkaqet dhe pasojat e sundimeve totalitar, si dhe për vlerat e përbashkëta evropiane, me qëllim promovimin e dinjitetit njerëzor dhe të drejtat e njeriut. Që kur u themelua, PEMC ka organizuar konferenca dhe takime ndërkombëtare (në Bruksel, Varshavë, Prag, Budapest, Viljandi, Estoni dhe Paris) si dhe mbledhjet vjetore të Këshillit të Anëtarëve (në Berlin, Hagë, Bruksel, Vroclav, Kiev, Vilnius dhe Bled të Sllovenisë). Këtë vit, takimi vjetor u organizua në Tiranë, më 3-6 Nëntor 2019 te Tirana International Hotel.</p> <p>Gjate takimit në Shqipëri, përveç zgjedhjeve të bordit dhe presidentit të ri të PEMC, në fokus të diskutimeve do të jetë edhe Rezoluta e re e Parlamentit Europian mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët evropiane, e cila u votua më 19 shtator 2019, ku Parlamenti Europian sugjeron të thellohet puna në fushën e edukimit dhe ndërgjegjësimin të brezit të ri, në rishikimin e kurrikulave shkollore përmes analizës së shkaqeve dhe pasojave që sollën regjimet diktatoriale, në nderimin e viktimave dhe mbi të gjitha në transparencën mbi krimet ndaj njerëzimit kryer nga regjimet naziste, fashiste, komuniste dhe sisteme të tjera diktatoriale.</p> <p>Programi i konferencës, ishte si më poshtë:</p>

	<p>Vizitë studimore në vendet e kujtesës në Shkodër;          Prezantim i ekspozitës “Totalitarizimi në Europë” te Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës në prani të medias lokale;          Vizitë studimore në vendet e kujtesës në Lezhë;          Vizitë studimore te Muzeu “Shtëpia e Gjethëve” në Tiranë;          Vizitë në Parlamentin shqiptar në kuadër të rezolutës së re të Parlamentit Europian mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane;          Tryezë të rrumbullakët “Politika e Kujtesës në Shqipëri dhe Europë”;          Ballafaqimi me të shkuarën në Shqipëri, veçanërisht roli i fonacionit gjerman Konrad Adenauer dhe IDMC</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;</i></p> <p><i>k) bashkëpunon me institucionet homologe të huaja.</i></p>
--	---

### 1.3 Kontribute në konferenca/ takime

**22 shkurt 2019** - Pjesëmarrje në Forumin "Kujtesa dhe demokracia," organizuar nga KAS, ISP & CRD, Gjirokastrë. Çelo Hoxha ligjëratë: "Lëvizja studentore 1990-91, si një ngjarje historike."  
 - Pasqyruar nga Zëri i Amerikës (<https://www.zeriamerikes.com/a/4800229.html>) dhe media të ndryshme vendase.

**25 mars 2019** - Pjesëmarrje në përurimin e librit Masakra e Tivarit, Uran Butka, Muzeu Kombëtar, ora 11.00.

**20 maj 2019** - Pjesëmarrje në përurimin monumentit të viktimave të regjimit komunist në Shkodër.

**24 maj 2019** - Takim me një delegacion gjerman - gazetarë, studies, etj., drejtuar nga Ana Kaminsky, të interesuar për punën e ISKK.



**18 qershor 2019** - Takim me përfaqësuesin ligjor të OSBE, Klaudio Pala, lidhur me projektligjin e Kuvendit të Shqipërisë që synon kufizimin e periudhës studimore të ISKK, duke hequr periudhën e luftës, si dhe bërjen të detyrueshme për punonjësit e ISKPK të kenë certifikatë sigurie nga DSIK.

**16 korrik 2019** - Pjesëmarrje në Komisionin e Ligjeve, për diskutimin e projektligjin për ndryshime në ligjin e ISKPK.

**23 korrik 2019** - Intervistë me një grup studentësh brazilianë të gazetarisë dhe shqiptarë (në Brazil) nga universiteti UNASP, San Paolo: Evelina Abdyl, Giancarlo Batistoti, Sarah Dornelis, Victor Bramdao.

**23 gusht 2019:** Pjesëmarrje në Promovimin e librit "Shkodra në vitet e vendosjes së diktaturës komuniste 1945-1953", organizuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër.

**27 shtator 2019** - Pjesëmarrje në konferencaën shkencore të Akademisë së Studimeve Albanologjike, "Ismail Qemal Vlora dhe elita politike shqiptare në procesin e shtetndërtimit." Akademia e Shkencave, salla Aleks Buda.

**3 tetor 2019** - pjesëmarrje në homazhe te varri i Mid'hat Frashërit, me rastin e 70 vjetorit të vdekjes. Pjesëmarrje në promovimin e botimit të Veprës së tij, vëllimi 4, nga Instituti Lumo Skëndo. Hotel Tirana, salla Balsha.

**15 tetor 2019** - pjesë marrje në ceremoninë e festimit të 10 vjetorit të hapjes së Fondacionit Konrad Adenauer në Shqipëri. Hotel Piazza.

**25 tetor 2019** - Pjesëmarrje në promovimin e librit Saga e Dhimbjes, e Fatbardha Saraçit-Mulleti në Shkodër, organizuar në Bibliotekën e qytetit, nga Bashkia Shkodër. Bashkë me Drejtorin, Agron Tufa, ku të dy mbajtëm nga një ligjëratë.

## 2. PROJEKTE

### 2.1 Projekte arsimore

#### 2.1.1

TITULLI PROJEKTIT	I	<b>“Këndi i kuq”- projekt pilot arsimor për përfshirjen e historisë së komunizmit në shkolla, të përshtatur për katër grupmosha (10-18 vjeç)</b>
KOHA REALIZIMIT	E	Prill-tetor 2019
PËRMBAJTJA		<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Në përgjigje të thirrjes së Komisionit European për aplikim për grante të vogla, në kuadër të programit ‘European Instrument for Democracy and Human Rights’ (EuropeAid/163516/DD/ACT/AL), Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, hartoi dhe aplikoi me një projekt dy-vjeçar të titulluar “Këndi i kuq”, i cili është një platformë e detajuar e përfshirjes së historisë së komunizmit në kurrikulat shkollore.</p> <p>Ky projekt konsiston në zbatimin e një modeli të ri të informimit rreth dramës së Komunizmit në shkolla, në materiale dhe teknika mësimore, duke prodhuar një literaturë të përshtatshme, tërheqëse dhe bashkëkohore, duke kualifikuar një staf pedagogjik, duke përfshirë aktivisht të rinj të niveleve të ndryshme, dhe duke zgjeruar njohuritë dhe perceptimin e publikut për komunizmin përmes përfshirjes së komunitetit të artit. Me pak fjalë, ky projekt ofron përgjigje për dy pyetje thelbësore në lidhje me të kuptuarit e komunizmit: "çfarë" dhe "si". Duke e konsideruar këtë projekt si një projekt pilot, përvoja e fituar nga zbatimi i saj, pritet të shërbejë si model për hartuesit e politikave në të ardhmen, duke çuar në këtë mënyrë drejt një reforme në arsim, në kontekstin e dekomunistizimit.</p> <p>Më konkretisht, ky projekt synon hartimin dhe botimin e katër teksteve mbi historinë e komunizmit, të përshtatura për katër grupmosha të ndryshme: 10-12 vjeç, 12-14 vjeç, 14-16 vjeç, 16-18 vjeç. Tekstet janë konceptuar të hartohen nga grupe punë prej katër vetësh: historianë, ekspertë të shkencave pedagogjike, sociologë dhe studjues të ISKK. Grupet e punës priten të hartohen në bashkëpunim me katedrat e universiteteve apo institucioneve të tjera studimore, pra, me bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilët konkurojnë me idetë e tyre dhe me arritjet në fushat përkatëse. Pas hartimit dhe botimit të teksteve, mësuesit e historisë, edukatës qytetare dhe sociologjisë në shkollat</p>

të cilat pritet të aplikohet ky projekt pilot, i nështrihen një workshopi trajnimi mbi mënyrën e lëvrimin të këtyre teksteve në shkolla.

Në një fazë më të vonshme, projekti synon realizimin e një serie bisedash nëpër shkolla dhe vizitash në vendet e memories, për ta bërë të prekshme historinë për të rinjtë.

Titulli i projektit që ne propozojmë revokon një nga simbolet më domethënës të realitetit komunist, "Këndin e Kuq" - një dhomë festive ose një qoshe salle, e kompozuar me synime propagandistike, dhe e dekoruar me attribute komuniste.

"Këndi i Kuq" është hartuar si një projekt gjithëpërfshirës kombëtar i arsimit/kulturës, me një plan kombëtar strategjik me fokus kryesor në shkolla, që nënkupton drejtpërdrejt: nxënës, mësues, studiues, ekspertë arsimit dhe politikëbërës arsimorë. Integrimi i aktiviteteve të kulturës si aktivitete mbështetëse, përmes prekjes estetike/emocionale, supozohet se rrit interesin e të rinjve për këtë temë, duke rritur në të njëjtën kohë edhe efikasitetin e projektit shkollor. Por strategjia e aktiviteteve supozohet të shumëzohet me rolin e të rinjve në projekt, përfshirë edhe konkurset e bazuar mbi një qasje të pavarur drejt temës. Pra, nisur nga natyra shumë-disiplinore dhe në disa nivele e këtij projekti, pritet që të rinjtë të zhvillojnë një opinion të pavarur dhe kritik për komunizmin, për vlerat njerëzore, të drejtat e njeriut dhe demokracinë, të cilat do të materializohen nga garat midis shkollave në fund të projektit. Pra, përmes një procesi hap pas hapi, ky projekt ofron një qasje të ndryshme për historinë e komunizmit, duke filluar nga përgatitja e literaturës / materialeve didaktike dhe metodologjisë së mësimdhënies, te procesi i të nxënës, tek procesi krijues i të mësuarit dhe deri tek procesi reflektues.

Për zbatimin e këtij projekti, ISKK i duhet doemos një mbështetje, partner financiar, që është edhe arsyeja që ISKK aplikoi për grant. Për shkak të buxhetit të vogël të ISKK, pra kapacitetit të pafavorshëm financiar për menaxhim granti, ky projekt, u rendit i dyti në listë dhe është konsideruar në listë pritjeje për financim nga Komisioni European deri në fund të vitit 2020.

Baza ligjore:

Sipërmarrja dhe realizimi i mundshëm i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për

	<p>“Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p>a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;</p> <p>i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;</p> <p>j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri.</p>
PARTNERË	Instituti për Politikat Publike dhe Zhvillim Social

### 2.1.2

TITULLI PROJEKTIT	I	<b>Botimi i librit me ilustrime mbi jetën e Sabiha Kasimatit “Kundër rrymës”, të përshtatur për fëmijë dhe me target shkollat nëntëvjeçare .</b>
KOHA REALIZIMIT	E	Qershor - dhjetor 2019
PËRMBAJTJA		<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Si pjesë e strategjisë për gjetjen e formave tërheqëse dhe të përshtatshme për përcjelljen e historisë së Komunizmit në shkolla, ISKK gjatë vitit 2019 realizoi botimin e një libri me ilustrime për fëmijë të titulluar “Kundër rrymës”, që është historia e shkencëtares Sabiha Kasimati, e ekzekutuar nga regjimi komunist si pjesë e grupit të inskenuar të incidentit të ‘bombës në Ambasadën Sovjetike në Tiranë’. Libri është një histori e përshtatur për moshat 10-13 vjeç, dhe është realizuar me bashkëpunimin e një grupi artistësh lituanëzë: artisten e njohur lituanëze Lina Itagaki si ilustratore, dhe Vytene Muschick &amp; Marius Marcinkevičius si narratorë. Projekti u mbështet financiarisht nga Fondacioni Konrad Adenauer.</p> <p>Një nga përparësitë e bashkëpunimit me artistët e huaj, ishte fakti që ata kishin përvojë në projektet didaktike, dhe historia është përshtatur për diskutim në klasë dhe është pajisur me shpjegues.</p> <p>Përgatitjes së librit, i parapriu një workshop dy-ditor i artistëve të huaj dhe përfaqësuesve të ISKK, në Tiranë dhe Korçë, që ka qenë edhe qyteti ku kreu</p>

	<p>liceun Sabihaja. Gjatë këtyre dy ditëve, jo vetëm u organizuan takime konsulence për të mësuar më shumë për jetën e Sabihasë, por u përcaktuan edhe detajet letrare dhe grafike të librit. Gjatë muajve në vazhdim, ekipi punoi online, deri në versionin final të dorëzuar për shtyp në fillim të muajit dhjetor.</p> <p>Prezantimi i librit u bë në konferencën “Ditët e kujtesës 2020” të organizuar nga Fondacioni Konrad Adenauer Tiranë dhe ISKK, me prezencën e autorëve. Libri do t’i propozohet Ministrisë së Arsimit që të përfshihet si tekst alternativ në programet shkollore të këtyre grupmohave, ndërkohëqë, gjatë vitit 2020, parashikohet që autorët të ftohen në Shqipëri nga ISKK për të drejtuar një workshop me mësuesit e historisë dhe artit, mbi mënyrën se si të serviret dhe të analizohet në shkolla vepra.</p> <p>Libri do t’u shpërndahet falas nxënësve dhe mësuesve që do të përfshihen në program. Për zgjerimin e njohurive mbi Komunizmin në Shqipëri edhe pëtej kufijve, pritet që libri të botohet edhe në gjuhën angleze.</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj Institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;</i>  <i>i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;</i>  <i>j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri.</i></p>
PARTNERË	Fondacioni Konrad Adenauer

### 2.1.3

TITULLI PROJEKTIT	I <b>Bisedë me studentët dhe pedagogët e Univesitetit European të Tiranës (UET).</b>
KOHA REALIZIMIT	E 3 maj, 2019

PËRMBAJTJA	<p>Përshkrimi i projektit</p> <p>Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKPK), prezantoi para studentëve pedagogëve të UET, kolanën e botimeve vjetore, shkencore e dëshmuere të vitit 2018. Më pas, një një sesion diskutimi, përfaqësuesit e këtij Institucioni, Drejtori Ekzekutiv z.Agron Tufa dhe Zv.Drejtori z.Çelo Hoxha, patën kënaqësinë t'u përgjigjen pyetjeve të studentëve dhe të pranishmëve lidhur me disa aspekte të punës së ISKK, si: mundësitë e dokumentacionit arkivor dhe roli i dëshmisë; përpunimi i materialit arkivor; çështja e Luftës së Dytë Botërore; objektiviteti në trajtimin e ngjarjeve të Komunizmit; përfshirja e studimeve të ISKK në programet shkollore, etj.</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p>a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;</p> <p>i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;</p> <p>j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri.</p>
PARTNERË	Universiteti European i Tiranës

#### 2.1.4

TITULLI I PROJEKTIT	<b>Bisedë me studentë të Masterit Shkencor dhe Masterit Profesional në Histori, në Departamentin e Historisë, Universiteti i Tiranës</b>
KOHA REALIZIMIT	10 dhjetor, 2019
PËRMBAJTJA	<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Në sallën Konrad Adenauer të Departamentit të Historisë, u mbajt një bisedë me studentë të Masterit Shkencor dhe Masterit Profesional në Histori, mbi “Kampin e Tepelenës dhe dëshmitë e të mbijetuarve të tij” nga Luljeta</p>

	<p>Lleshanaku, Drejtore e Studimeve në ISKK. Biseda u zhvillua në kuadër të lëndës ‘Historia dhe Kujtesa’, me fokus periudhën komuniste në Shqipëri. Dr.Enriketa (Pandelejmoni) Papa, duke prezantuar të ftuarën para audiencës, bëri edhe një rezymë të punës së ISKK në mbledhjen e dëshmimeve. Studentët ndoqën një film në 3D në formën e një muzeu virtual mbi Kampin e Tepelenës, të realizuar nga ISKK. Pas kësaj, u fol mbi përvojën në marrjen e dëshmimeve të mbijetuarve, si edhe botimin e kolanës “Zërat e kujtesës”, për rolin e dëshmisë në mungesë të dokumentacionit, për metodologjinë dhe teknikat e intervistimit, për trajtimin e dëshmisë mbi kritere shkencore si edhe mbi aspektin psikologjik të marrjes së dëshmimeve, duke e ilustruar bisedën me shembuj konkretë. Më pas, e ftuara iu përgjigj pyetjeve të shumta të studentëve lidhur me të shkuarën komuniste.</p> <p><u>Baza ligjore</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;</i>  <i>i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;</i>  <i>j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri;</i></p>
PARTNERË	Universiteti i Tiranës, Departamenti i Historisë

## 2.2 Projekte informuese/sensibilizuese

### 2.2.1

TITULLI PROJEKTIT	I <b>Prodhimi i filmit dokumentar në formë video-produksioni “Muzeu virtual i Kampit të Maliqit: pjesa I-rë”</b>
KOHA REALIZIMIT	E Janar- dhjetor 2019

## PËRMBAJTJA

### Përshkrimi i projektit

Ky film dokumentar, është pjesë e serisë së muzeve virtualë të burgjeve dhe kampeve gjatë regjimit komunist në Shqipëri, një projekt afatgjatë i ISKK, i cili filloi gjatë vitit 2018 me realizimin e filmit të parë dokumentar, Muzeun Virtual të Kampit të Tepelenës. Projekti konsiston të rikrijimin e këtyre kampeve përmes filmimeve në cilësinë 4K dhe me anë të grafikës 3D. Ky muze virtual, është një produkt dixhital që bazohet në karakteristikat e një muzeu, në mënyrë që të plotësojë, të zgjerojë njohuritë mbi këtë temë përmes personalizimit, interaksionit dhe pasurisë së përmbajtjes.

Si me një muze tradicional, ky muze virtual projektohet rreth objekteve të veçanta (të tilla si një muze arti apo një muze natyror ose historie) që janë rrënojat e vendeve të vuajtjes, objekteve personale ose publike që lidhen me këto vende, si edhe mbi faktet e sugjeruara nga viktimat që e kanë përjetuar këtë përvojë dhe dëshmitarët okularë të ngjarjeve në këto vende, për të krijuar në mënyrë imagjinare idenë dhe emocionin mbi të shkuarën komuniste.

Gjatë vitit 2019, ISKK punoi për realizimin e filmit të dytë në formë video-produksioni, që ishte Muzeu Virtual i Kampit të Maliqit. Ky kamp, njihet si një nga më të tmerrshmit përsa i përket punës së rëndë, urisë, dhe trajtimit mizor të të burgosurve, që filloi aktivitetin si i tillë në vitin 1947 dhe mbaroi, kur përfundoi edhe tharja e kënetës së Maliqit.

Gjatë punës kërkimore për të skicuar skenarin e filmit, grupi i punës hasi në një sërë vështirësish. E para, rezulton që kanë qenë tre kampe brenda të ashtuquajturit “Kampi i Maliqit” (Vloçisht, Orman –Pojan dhe Nizhavec) dhe jo dy siç merrej e mirëqenë deri tani; e dyta, përcaktimi i vendeve se ku ndodheshin saktësisht në hartë këto tre kampe, qe tepër i vështirë për shkak se nga kampet nuk ka mbetur asnjë gjurmë fizike, dhe se për shkak të distancës së madhe kohore nga ngjarja, nuk ekziston pothuajse asnjë i mbijetuar dhe dëshmitar nga këto kampe; dhe e treta, për rindërtimin e terrenit, i cili kaloi disa nivele transformimi (në përputhje me stadi e tharjes së kënetës), nevojiteshin harta të posaçme, kryesisht inxhinierike, një proces shumë i vështirë, gati i pamundur për t’u menaxhuar. Kështuqë kërkimi ka qenë i thelluar dhe i shtrirë në disa arkiva.

Për shkak të vështirësive të përmendura më sipër, projekti u nda në dy pjesë. Gjatë vitit 2019, ne realizuam pjesën e parë të tij, dy të tretat e filmit. Deri në fund të muajit qershor 2020, pra gjysmën e parë të këtij viti, do të realizohet



pjesa e dytë e tij. Në fund të muajit qershor 2020, në një konferencë të posaçme që do t'i dedikohet kampeve të punës në Maliq, do të shfaqet edhe premiera e filmit.

Për prodhimin e këtij video-produksioni, grupi i punës ka vepruar në këto drejtime:

- Punë kërkimore në arkiva
- Punë kërkimore në Arkivën e filmit
- Punë kërkimore në shtypin e shkruar
- Mbledhja dhe hulumtimi i gjithë dëshmimeve të mbijetuarve mbi kampet e Maliqit
- Mbledhja dhe analizimi i literaturës mbi këtë tema
- Shpallja e tenderit dhe kontraktimi i kompanisë së video-produksionit
- Hartimi i skenarit
- Produksioni: filmimet në terren & arkitektura grafike në 3D
- Post-produksioni

Ashtu si edhe me filmin e parë, pas premierës së tij, “Muzeu virtual i kampit të Maliqit” do të futet në internet, në mënyrë që të ketë një akses të gjërë në publik, sidomos tek të rinjtë. Klipet do të jenë të aksesueshëm për të gjithë shikuesit në faqen zyrtare elektronike të ISKK, si edhe në youtube. Ndërkohë faqja në të cilën do të botohet Muzeu Virtual i Komunizmit, do të vihet në lidhje me link-e të tjera insitucionesh të kujtesës, të cilat kanë një mision të ngjashëm studimi me ISKK, dhe i shërbejnë transparencës së të shkuarës komuniste.

#### Qëllimi i projektit:

Informimi dhe sensibilizimi publik mbi kampet e punës së detyruar, burgjet politike, dhunën dhe keqtrajtimin e të burgosurve në Shqipërinë komuniste.

#### Baza ligjore:

Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:

- f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;*
- g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;*

	<p>gj) përpunon, në formë elektronike, të gjithë dokumentacionin për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;</p> <p>h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri.</p>
PARTNERË	Fondacioni Konrad Adenauer

## 2.2.2

TITULLI PROJEKTIT	I	<b>Ekspozita fotografike “Shqipëria komuniste: realiteti dhe propaganda”</b>
KOHA REALIZIMIT	E	16 dhjetor- 26 dhjetor, 2019
PËRMBAJTJA		<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Pas një punë të gjatë kërkimore në arkiva, ISKK arriti të sigurojë foto dhe dokumenta të cilat kanë një domethënie të fuqishme për atë ç’ka përfaqësojnë, materiale të cilat ISKK vendosi t’u ndajë me publikun përmes një performancë publike, një lloj ekspozite të shoqëruar me elementë performancës (zë, muzikë, dizejn), e cila u hap në ambientet e këtij Instituti për dhjetë ditë radhazi (16-26 dhjetor 2019). Titulli i ekspozitës ishte “Shqipëria komuniste: realiteti dhe propaganda”. Kjo veprimtari synoi përcjelljen e evidencave të persekutimit komunist në Shqipëri dhe të tjetërsimit të realitetit nga propaganda. Ekspozita u materializua me fotografi të vrasjeve në kufi; fotografi të ish të burgosurve politikë të marra në hetuesi dhe burgje; fotografi të klerikëve të burgosur dhe të ekzekutuar; fotografi të miturish në ambasadat e huaja në ngjarjen e 2 korrikut 1990; fotografi qytetarësh të huaj të burgosur në Shqipëri, etj.</p> <p>Fotot ishin origjinale dhe të paksposuara më parë. Përveç fotografive, u shfaqën edhe dokumente ose pjesë dokumentesh të afishuar. Në sfond të këtij realiteti, përmes zërit (copëza fjalimesh, kronika televizive, pjesë muzikore nga propaganda e regjimit), u improvizua propaganda komuniste, e cila ishte në kontrast të plotë me atë ç’ka shihej. Pikërisht, paradoksi midis asaj që ishte (realitetit të shprehur përmes fotove) dhe asaj që dëgjohej (propagandës), përbennte edhe konceptin e këtij aktiviteti.</p>

	<p>Falë edhe pozicionit të Institutit në një nga zonat më të populluara të Tiranës, ekspozita arriti të tërhiqte kureshtjen e publikut dhe të medias. Prej impaktit të fuqishëm që përcjell imazhi, drama e komunizmit u bë më e prekshme, veçanërisht për brezin e ri, duke qenë që ishin veçanërisht të rinjtë ata që shfaqën edhe interesin më të madh.</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;</i>  <i>e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit së Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;</i>  <i>h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri.</i></p>
PARTNERË	Fondacioni Konrad Adenauer

### 2.2.3

TITULLI PROJEKTIT	I <b>Pjesëmarrja e ISKK në Panairin e Librit “Tirana 2019”</b>
KOHA REALIZIMIT	E 13-17 nëntor, 2019
PËRMBAJTJA	<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Për një kontakt më të drejtëpërdrejtë me lexuesin, për tërheqjen e vëmendjes ndaj aktivitetit dhjetëvjeçar të saj dhe për sensibilizimin publik, ISKK u prezantua për herë të parë me një stendë të veten në Panairin e Librit të mbajtur në Tiranë, më 13-17 nëntor, 2019.</p> <p>Në stendë u ekspozuan rreth 95 tituj librash dhe revistash, të botuar në një hark kohor prej shtatë vjetësh, në të cilët përfshihen botimet studimore, memoret,</p>

	<p>botimet me natyre publicistike dhe krijimtari dhe përkthime nga burgjet dhe kampet e internimit.</p> <p>Gjatë ditëve të panarit, ISKK organizoi edhe një prezantim të zgjeruar të dy prej botimeve të fundit: “Krimet e komunizmit: një histori e plotë për në mirditën (1944-1950)” të Tanush Kasos dhe monografinë “Martiri Dom Shtjefen Kurti” nga Nikolin Kurti e Nikollë Loka.</p> <p>Interesi për botimet e ISKK në këtë dalje të parë duket që qe i madh, pasi një nga botimet e fundit, ”Grabjani rrëzë kodrave”- skena, personazhe, historira nga fshati i internimit në vitet ‘70-’80” i Lekë Tasit, u vlerësua si vepra më e mirë e Panaritit të Librit 2019, në gjininë e publicistikës.</p> <p><u>Baza ligjore:</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</p> <p><i>h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri;</i></p> <p><i>i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit.</i></p>
--	---

## 2.3 Projekte dokumentuese

### 2.3.1

TITULLI PROJEKTIT	I	<b>Krijimi i arkivës audio-vizuale të dëshmime të ish- të përndjekurve poltikë</b>
KOHA REALIZIMIT	E	Janar- dhjetor 2019

## PËRMBAJTJA

### Përshkrimi i projektit

Ky projekt afatgjatë konsiston në një seri video-regjistrimesh me rrëfimet e vuajtësve të drejtëpërdrejtë dhe dëshmitarëve të krimeve të komunizmit në Shqipëri. Mbledhja e dëshmimeve të të mbijetuarve të persekutimit komunist, dhe krijimi i një arkive audio-vizuale shërben si bazë kërkimore për studjuesit, por publikohet në forma të ndryshme: botime, filma, muze, media. Në mungesë të evidencave zyrtare, ky projekt plotëson një hallkë shumë të rëndësishme në rikompozimin, rishkrimin e historisë së krimeve të Komunizmit, sidomos në aspektin cilësor.

Pra, projekti bazohet në përshkrimin cilësor më tepër se atë statistikor të ngjarjeve, i cili vjen përmes rrëfimit të përvojave, ku detajet, situatat konkrete, konteksti, personazhet realë të përfshirë në to, e bëjnë jo vetëm të pakontestueshme përvojën individuale, por, ndihmojnë edhe në plotësimin e kornizës së plotë të ngjarjeve. Si i tillë, ky projekt, më shumë se çdo iniciativë tjetër, krijon antropologjinë e regjimit komunist në Shqipëri.

Procesi i realizimit të video-regjistrimeve, kalon nëpër këto faza:

- Përzgjedhja dhe kontakti me të intervistuarit
- Informimi i të intervistuarit mbi natyrën e projektit, dhe se çfarë kërkohet prej tij.
- Intervistimi (disa orësh, me ose pa ndërpreje)

Gjatë vitit 2019, ISKK arriti të realizojë 30 orë video-regjistrime.

Duke filluar nga viti 2012 që filloi ky projekt, ISKK ka botuar 5 vëllime me intervista (dëshmi) të transkriptuara, në kolanën e quajtur “Zërat e kujtesës” dhe gjatë 2019, ka përgatitur vëllimin e 6-të.

### **Qëllimi i projektit:**

Evidentimi i krimeve të komunizmit përmes rrëfimit gojor të të mbijetuarve dhe publikimi i tyre.

### **Baza ligjore**

Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:

	<p>f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;</p> <p>g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;</p> <p>e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist.</p>
PARTNERË	<p>Shoqatat e Ish të Përndjekurve Politikë</p> <p>Instituti i Integrimit të Ish të Përndjekurve Politikë</p>

### 2.3.2

TITULLI PROJEKTIT	I	<b>Krijimi i një database-i mbi viktimat e komunizmit</b>
KOHA REALIZIMIT	E	Janar-dhjetor 2019
PËRMBAJTJA		<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Në vitin 1993-1995, nga Komiteti i Integrimit të Ish të Përndjekurve Politikë dhe filialet e tij nëpër rrethe, u arrit të bëhej një regjistrim i individëve të persektuar në bazë të dokumentacionit mbështetës nga Ministria e Puneve të Brendshme, dhe Ministria e Drejtësisë. Dhe mbi këto të dhëna u bë përcaktimi i statusit të persektuarve sipas kategorive, që do të shërbente më vonë edhe si bazë dokumentuese, për shpërblimin e tyre financiar. Por, ky regjistër është i paplotë, sepse është ndërtuar në bazë të kërkesave të interesuarve, jo në bazë të një studimi shterues mbi baza shkencore. Nga kërkimet e deritanishme të ISKK, numri i të dënuarve të të gjitha kategorive, është shumë herë më i madh se shifra aktuale zyrtare. Nga ana tjetër, stasisikat e deritanishme, përveçse të paplota, janë të pa-aksesueshme nga publiku.</p> <p>Një nga projektet afatgjatë të ISKK, është pikërisht krijimi i një databaze, me të dhëna zyrtare mbi të dënuarit, format e dënimeve, kohëzgjatjen e dënimeve, dhe vendimet me të cilat janë bërë këto dënime. Drejtoria e Arkivës ka ngritur një grup pune për mbledhjen, pasurimin dhe organizimin e informacionit. Grupi i punës i ngarkuar për krijimin e database-s, mbledh</p>

informacion për personat të cilët, u dënuan politikisht që nga viti 1944 kur komunizmi u instalua, e deri në vitin 1991, me rënien e tij.

Në këtë database, përfshihen: të ekzekutuarit, të vdekurit në burgje; të burgosurit; të internuarit në kampet me tela; të internuarit në kampet e punës; të dëbuarit.

Për hartimin e këtij database, grupi i punës i referohet: dokumenteve të marra nga Instituti i Integritetit të Ish- të Përndjekurve Politikë; dokumenteve të Ministrisë së Drejtësisë; dokumenteve të arkivës së Ministrisë së Brendshme; dokumenteve arkivore në Drejtorinë e Arkivave të Shtetit; dokumenteve të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; studimeve akademike; shtypit zyrtar të periudhës 1944-1991; fletore zyrtare; arkivave të huaja; arkivave të shoqatave shqiptare në ekzil; arkivës së Ministrisë së Jashtme; dëshmime të ish të persekuarve politike dhe bashkvuajtjsve të tyre; dokumenteve në Bibliotekën Kombëtare; studimeve akedemike të universiteteve të huaja mbi këtë temë.

Gjatë vitit 2019, kemi grumbulluar një numër të konsiderueshëm dokumentesh në lidhje me ligjet represive të miratuara gjatë regjimit komunist, me synimin përgatitjen e një vëllimi të posaçëm në lidhje me këtë temë. Konkretisht, janë marrë dhe përpunuar këto dokumente në arkiva:

#### AQSH:

Fondi 14/APL: 332 dosje, rreth 6000 faqe dokumente.

#### AIDSSH:

Janë marrë këto dokumente:

- Dosje formulare 5076 nga arkivi i Ministrisë së Brendshme.
- Platforma e sigurimit e vitit 1948, 1958, 1986, 1987; Historiku i Sigurimit
- Dosje nga arkivi i Ministrisë së Brendshme: Fondi 4 (Shtabi) - 48 doje.

#### Baza ligjore

Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:

	<p>c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;</p> <p>ç) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;</p> <p>e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;</p> <p>gj) përpunon, në formë elektronike, të gjithë dokumentacionin për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;</p> <p>i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit.</p>
PARTNERË	<p>Shoqatat e Ish të Përndjekurve Politikë</p> <p>Instituti i Integritimit të Ish të Përndjekurve Politikë</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave</p> <p>AIDSSH</p>

### 3. BOTIMET

#### 3.1 Botimet studimore/dokumentuese

##### “Fjalor enciklopedik i viktimave të terrorit komunist”,

Vëllimi VIII (Gërmat ‘Sh’, ‘T’, ‘Th’, ‘U’, ‘V’)

Gjatë vitit 2018, u përgatit për shtyp dhe u botua, volumi i VIII-të i këtij fjalori enciklopedik, i cili përfshin të gjitha format e dënimeve politike (ekzekutim, burgim, internim dhe dëbim), argumentimin ligjor dhe kohën e vuajtjes së dënimit. Puna u zhvillua në dy faza: përzgjedhja e dokumenteve përkatëse për vëllimin nga grupi i përgjithshëm i dokumenteve, radhitja, verifikimi, plotësimi, redaktimi, dhe faqosja.



Për këtë numër u konsultuan dhe radhitën (zbardhën) rreth 6000 dokumente: deklaratat personale, vendime gjyqi, vendime të Komisionit tre palësh; këto dokumente janë grumbulluar nga punonjësit e arkivës dhe gjenden në arkivën elektronike të ISKK. Veç këtyre janë shfrytëzuar dhe materiale të botuara si gazeta, libra, etj., të cilat janë dhënë me referenca të sakta në vëllimin e botuar. Puna u zhvillua në dy faza: një, përzgjedhja e dokumenteve përkatëse për vëllimin nga grupi i përgjithshëm i dokumenteve, rreth 60 mijë dokumente elektronike (dokumente origjinale të fotografuara; dy, dokumentet e përzgjedhura (rreth 5000) u radhitën. Proces tjetër ishte redaktimi i materialit që u bë nga dy redaktorët përgjegjës për përgatitjen e enciklopedisë.

Ky botim projektton më së miri mekanizmin e fabrikimit të elementit ‘armik’, instrumentalizimin e ligjit, dënimin për fajet të pakryera, dhe përdorimi i tyre si mjete presioni ndaj pjesës tjetër të popullsisë.

## **“I lumi Dom Shtjefën Kurti, dëshmitar i kishës martire” vol. II - monografi**

**Autorë:** Nikolin KURTI, Alfred Duka, Nikollë LOKA

Ky është vëllimi i dytë monografik kushtuar Dom Shtjefën Kurtit, që më së shumti simbolizon persekutimin e klerit katolik në Shqipëri nga regjimi komunist. Dom Shtjefën Kurti ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për bashkimin e shqiptarëve dhe në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve; me mbështetjen e Mbretit Zog, hartoi përkujtesën “Gjendja e pakicës shqiptare në Jugosllavi”, e cila iu dërgua Lidhjes së Kombeve në Gjenevë.

I arsimuar në Itali dhe Austri, me një reputacion të jashtëzakonshëm në popull si klerik dhe atdhetar, viti 1945 e gjeti Dom Shtjefën Kurtin famulltar në kishën e famullisë katolike në Tiranë. Por këtu fillon edhe përndjekja e tij që nuk ndalet asnjë çast deri në vdekjen e tij. Më konkretisht, ai u arrestua në vitin 1946 dhe u dënua me 20 vjet burg si agjent i perëndimit. Lirohet nga Burgu i Burrelit në vitin 1966, dhe arrestohet sërish në vitin 1971, për spunazh, sabotazh, dhe kryerjen në fshehtësi të riteve fetare. Madje historia e tij e ekzekutimit vetëm për shkak se pagëzoi një fëmijë, ka mbetur në kujtesën kolektive si një nga përvojat më absurde dhe më të shëmtuara të komunistëve. U pushkatua, por sot e kësaj dite nuk gjenden eshtrat e tij. Me 5 Nëntor 2016, Dom Shtjefën Kurti qe një nga 40 klerikët që u lumnua si “Martir” dhe u pranua shenjtor i Kishës Katolike.

Për hartimin e vëllimit II, autorët u janë referuar dokumentacionit të AQSH, Ministrisë së Brendshme, arkivës së Vatikanit, si edhe studimeve të shumta dhe artikujve shkencorë të realizuar deri tani mbi Klerin Katolik, që në këtë rast shërbejnë si burime të ndërmjetme referimi. Një pjesë e konsiderueshme e librit është analizë ligjore e pushkatimit të D. SH. Kurtit, ku evidentohet shkelja e ligjeve ekzistuese në kohën e kryerjes së veprimit. Në libër trajtohen dhe protestat e bëra për pushkatimin e D. SH. Kurtit në Europë dhe SHBA, dëshmi të mbledhura nga Selia e Shenjtë

për figurën e D. SH. Kurtit, etj. Monografia kushtuar D. SH. Kurtit, botuar nga ISKK 2018, u vlerësua me çmimin "Libri më i mirë", në konkursin për nder të 110 vjetorit të gazetës Dielli, SHBA.

**Titulli: "Partia Komuniste Shqiptare në Luftën e Dytë Botërore, nëntor 1941 – nëntor 1944"**

**Autor:** Luan Dode

Një monografi që trajton historinë e PKSHP nga krijimi i saj (nëntor 1941) deri në fund të luftës, kur ajo mori pushtetin (nëntor 1944). Autori e vendos krijimin e PKSHP në një kontekst të plotë ndërkombëtar dhe kombëtar, duke trajtuar kushtet jashtme dhe të brendshme që çuan në krijimin e saj. Libri trajton mbledhjen themeluese, organizimin e partisë në qendër e në bazë dhe rolin e dy komunistëve jugosllavë, anëtarë PKJ, M. Popoviç e D. Mugosha, në këtë veprimtari. Veç tyre, në libër trajtohet dhe veprimtaria e komunistëve të tjerë jugosllavë të cilët erdhën më vonë në Shqipëri.

Roli i komunistëve jugosllavë, sipas autorit, është kyç në njohjen e historisë së PKSHP, sepse ai ishte dominues në disa nga momentet më të rëndësishme të kësaj partie. Bazuar në dëshmitë e komunistëve shqiptarë, autori analizon krijimin e KQ të PKSHP në mars 1943, i cili u krijua me persona të emëruar nga emisarët jugosllavë, kryesisht M. Popoviçi. Edhe roli kryesor që mori Enver Hoxha në këtë strukturë të PKSHP ishte nën ndikimin e jugosllavëve dhe jo rrjedhojë e zgjedhjes nga anëtarët e KQ. Siç dëshmon E. Hoxha në Plenumin e Beratit (nëntor 1944), burim historik të cilit i referohet autori, marrëdhënia e komunistëve shqiptarë me komunistët jugosllavë ishte pak a shumë marrëdhënie varësie, e përafërt me rolin mësues-nxënës. Kjo marrëdhënie vazhdoi e tillë për shumë kohë dhe pati ndikim në marrëdhëniet mes PKSHP dhe formacionave të tjera politike shqiptare që vepruan në të njëjtën periudhë. Në monografi bëhet një analizë e gjerë e ndikimi të jugosllavëve në marrëdhëniet e komunistëve shqiptarë me nacionalistët, duke trajtuar rolin e tyre në Konferencën e Pezës (1942), në prishjen e Marrëveshjes së Mukjes (1943), në fillimin e luftës civile, etj. Roli i jugosllavëve në marrjen e pushtetit nga komunistët shqiptarë është përkufizuar në mënyrë lakonike nga Liri Gega në Plenumin e Beratit (nëntor 1944), e cila u shpreh: "Sikur të mos na kishte ardhur ndihma e dytë e Partisë Jugosllave, gjithë këtë luftë ne do ta kishim humbur".

Në përgjithësi studimi bazohet në materiale burimore arkivore, por dhe burime të tjera të botuara, si monografi, artikuj studimorë, gazeta, kujtime, etj.

**Titulli: "Revolta e Zhapokikës, 1948", monografi**

**Autor:** Xhezo Cana

Kjo monografi trajton një nga ngjarjet më dramatike të viteve të para të regjimit komunist, e cila ndodhi në Zhapokikë të Tepelenës, më 1948. Revolat paraqitet në gjithë dinamikën e saj: origjina, organizimi dhe përplasja me armë me forcat e regjimit komunist.

Në pjesën e parë jepet një pasqyrë e plotë mbi rrethanat politike dhe ekonomike në të cilat lindi revolta, lexuesi njihet me motivet e pakënaqësisë dhe fillesat e organizimit kryengritës. Duke ndjekur kapitujt në vazhdim, autori shpalos hap pas hapi ecurinë në rritje të konfliktit deri në përplasjen e armatosur, në shtypjen e kryengritjes dhe arrestimin e pjesëmarrësve, ndaj të cilëve gjykatat dhanë vendime të ashpra: pushkatime e dënime me vite të tëra burgosje, ndërsa familjarët pësuan internime e luftë të pandërprerë klasore.

Në këtë revoltë të armatosur u përfshinë banorë nga disa fshatra të Tepelenës, si Zhapokika, Luftinja etj. Revolta përfundoi me vrasjen e tre pjesëtarëve të forcave kryengritëse dhe arrestimin e 26 të tjerëve. Dhuna vazhdoi mbi dhjetra e dhjetra persona të tjere të burgosur me qindra vite burg dhe internim. Siç thuhet në parathënien e kësaj monografie, në thelbin e revoltës ishte shpirti shekullor i fshatarit të lirë, ky entitet socialhistorik, i rralluar gjetkë, por i ruajtur gjer vonë ndër malësitë shqiptare. Ky fshatar i lirë, i gjetur si i tillë e i pranuar nga çdo regjim, mbijetoi thuajse i pacënuar deri në marrjen pushtetit nga komunistët.

Autori ka shfrytëzuar një sërë burimesh arkivore, shumica të shfrytëzuar për herë të parë. Burimi kryesor ka qenë dosja gjyqësore e të dënuarve lidhur me këtë ngjarje, marrë nga Arkivi i Ministrisë së Brendshme. Po kështu janë shfrytëzuar mbi 700 faqe dokumente zyrtare, marrë përmes Autoritetit të Dosjeve, kryesisht materiale të pa shrytëzuara më parë, për shkak se kanë qenë të klasifikuara. Gjithashtu për të plotësuar këtë libër referimi janë libra dhe gazetat të ndryshme.

### **Titulli: "Doracak termash të diktaturës komuniste"**

**Autor:** Kastriot Dervishi

Ky libër është një fjalor i vogël me terma, togfjalësha, akronime dhe emërtesa të përdorur gjatë regjimit komunist, të cilat tani nuk përdoren më në të folmen e përditshme ose në ligjërimitin zyrtar, por gjenden në librat e historisë, përgjithësisht pa shpjegime kuptimore ose etimologjike dhe paraqesin vështirësi për brezin e ri, sidomos ata që kanë lindur pas vitit 1990.

Shkurtesa të tilla si PKSH, PPSH, KQ, apo me karakter teknik e profesional si SRV, 2A, 2B, PP, etj, do sjellin në të ardhmen vështirësi kuptimi. Shumë prej këtyre fjalëve duke mos qenë më pjesë e fjalorit të përditshëm njerëzor, bien në humnerën e thellë të rrezikut të harresës, duke u bërë pengesë për të kuptuar në mjaft rast kohën apo ngjarje të saj. Pikërisht për këtë shërben ky doracak i vogël. Shpjegohen parime dhe simbole të regjimit komunist, çështje ideologjike, organet kryesore të shtetit e partisë, organet e punëve të brendshme, krimet kundër shtetit, llojet e dosjeve, etj.

Çdo shpjegim ka karakter të përgjithshëm dhe orientues. Sidomos disa fjalë që kanë të bëjnë me organet e punëve të brendshme të diktaturës, në jo pak raste nuk kuptohen, por edhe kanë sjellë keqkuptime duke ngatërruar bashkëpunëtorin me të ndjekurin. Pavarësisht se një pjesë e tyre kanë

karakter teknik, keqkuptimi ka pasur efekt të fortë dhe ka lënë përshtypje te një pjesë e madhe e qytetarëve.

Libri është një doracak i dobishëm për nxënësit e shkollave, të cilët studiojnë periudhën e regjimit komunist në lëndën e historisë.

**Titulli: “Nikollë Dakaj, mes perkthimit dhe proceseve politike”.**

**Autor:** Leka ndoja

Siç është parashikuar edhe në planin vjetor, ka përfunduar përgatitja e monografisë “Nikollë Dakaj, mes perkthimit dhe proceseve politike”, që përben edhe volumnin e VI-të të serisë së botimeve “Akte gjyqësore politike gjatë komunizmit në Shqipëri”, e cila është një Kronologji e platformave politike, të Sigurimit të shtetit, dhe të DMP sipas Historikut të Armës të Sigurimit Shtetit

**Titulli: “Abuzimi me pronën në Shqipërinë komuniste: 1945-1946”**

**Autor:** Alvin Saraçi

Kjo është monografi dokumentare me fokus abuzimin mbi pronën, reformat komuniste, dhe aktet ilegjitime gjatë periudhës 1945-1946. Seria e dokumenteve që i prezantohet lexuesit është përzgjedhur nga disa fonde të Arkivave të Shtetit Shqiptar që i përkasin Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Bankës së Shtetit, etj dhe reflektojnë abuzimet me pronën në periudhën komuniste. Nëpërmjet letërkëmbimit, qarkoreve, telegrameve, peticioneve etj, del në pah politika e cënimit dhe kufizimit të pronës private dhe centralizimit e kontrollit të ekonomisë nga ana e shtetit, që u sanksionua nëpërmjet ligjeve të konfiskimit, të cilat përfshinë të arratisurit, të burgosurit politikë, pasuritë shtetërore dhe private të vendeve që humbën luftën. U shpronësua shtresa e lartë dhe e mesme e tregtarëve, u shtetëzuan sipërmarrjet private etj. Shteti ndërhyrhyri gjithashtu edhe në notat e transkriptimit të hipotekave, bllokoi pasuritë private pas masës së sekuestrimit dhe ia kaloi përfundimisht shtetit pas konfiskimit. Ky studim merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur akoma mbetet i pazgjidhur problemi i rikthimit të pronës dhe kur brezit të ri i duhet të njohë background-in e problemit, për të kuptuar realitetin e sotëm ekonomik në Shqipëri.

**Titulli: "Sytki Hoxha, një jetë i burgosur"**

**Autor:** Qemal Velija

Ky libër i kushtohet Sytki Hoxhës, i cili vuajti 37 vjet burg dhe internim, 1950-1987. Sytki Hoxha lindi më 1927 në Gjakovë, Kosovë. Gjatë luftës, ende i ri, mori pjesë në forcat partizane të

Kosovës. Pasi Jugosllavia u përjashtua nga Informbyroja (1948), në shkurt 1949 kaloi në Shqipëri dhe kërkoi strehim politik, me mendimin se po vinte në një vend socialist, të ngjashëm me Hungarinë apo Çekoslllovakinë, por u zhgënjye shpejt. Për arsye ekonomike, punoi si redaktor në gazetën e emigracionit "Za Slobodu" si dhe shkruante artikuj në shtypin e kohës dhe komente për Radio Tiranën. Ndërkohë vazhdoi edhe fakultetin e gjuhë-letërsisë. Shpejt do të përfundojë në kampet e internimit si në Llakatund të Vlorës, Seman të Fierit, Çermë të Lushnjës dhe Berat. Pas vizitës së Hrushovit në Beograd (1956), kërkoi të kthehej në Jugosllavi por nuk u lejua. Kështu që Sytkiu, i cili gjendej në kampin e Llakatundit, pa pasur mundësinë e dokumentacionit të rregullt, tentoi të kalojë kufirin për t'u kthyer në Kosovë. Më 1957, u arrestua në Korçë, dhe iu kërkua të zgjidhte, ose të firmoste për të bashkëpunuar me Sigurimin dhe të lirohej, ose të vuante burg. Ai pranoi të nënshkruante, me shpresën që ta lironin dhe të arratisesh, ashtu diç edhe ndodhi. Pas lirimit, ai ua tregoi miqve faktin që kishte nëshkruar, dhe shumë shpejt tentoi të arratisesh përsëri, por sërish u arrestua dhe u dënua me burg. Brenda burgut u dënua disa herë, në total u dënua me 41 vjet burg, vuajti 30 vjet burg. Në hetuesi provoi torura të ndryshme, përfshi elektroshokun, prej të cilave pati dhe pasoja si thyerje të kafkës dhe çrregullime të të ngrënit. U lirua nga burgu më 1987; kërkoi të largohej në Jugosllavi, por tashmë nuk i jepte vizë shteti jugosllav. U largua nga Shqipëria më 1990.

### **Titulli: "Ramize Gjebrea: një jetë për një tjetër kohë"**

**Autori:** Vasfi Baruti

Ky libër është një monografi për jetën e Ramize Gjebresë, e pushkatuar gjatë luftës nga Brigada V partizane. Libri ka një shtrirje të gjerë në jetën e saj, duke përfshirë periudhën e saj studentore, angazhimin në lëvizjen komuniste dhe në forcat partizane, historinë e ekzekutimit të saj, si dhe analizon qëndrimet kontradiktore për historinë e ekzekutimit të saj.

Gjebrea ka qenë një veprimtare e spikatur në qëndresën antifashiste; ajo mori pjesë në demonstratën antifashite më 28 tetor 1941, arsye për të cilën u përjashtua nga shkolla. Më vonë u përfshi në lëvizjen komuniste dhe veproi me detyrën e sekretares për rininë në zonën Vlorë, Mallakastër dhe Gjirokastër, ose, siç u quajt më vonë nga komunistët, Zona I Operative.

Çështja e ekzekutimit të saj ka qenë e diskutueshme për një kohë të gjatë dhe ende vazhdon të mbetet e tillë. Në versionin e parë zyrtar u tha se ajo u dënua për çështje imoraliteti, por pas lufte Gjykata e Lartë Ushtarake i dha pafajësi dhe ajo u shpall dëshmore, pastaj i hiqet ky status, ndërkohë familjarët e saj u persekutuan, etj.

Autori përpiket të argumentojë tezën e tij që Ramize Gjebrea u vra për arsye politike, nën ndikimin e Dushan Mugoshës, i cili ka qenë pjesëmarrës në gjyqin e saj, dhe, për rolin e të cilit në këtë ngjarje, Nijaz Dizdareviç, i dërguar i PKJ në Shqipëri, shkruan në kujtimet e tij: "Vendimin për pushkatimin e Ramize Gjebresë e shkroi vetë Dushan Mugosha."

### **3.2 Botime memuaristike**

**Titulli: “Unë dhe shtatë të burgosurit e familjes sime” – memuaristikë**

**Autori: Kolec M. Traboini**

Në këtë libër me kujtime, autori, ish i burgosur politik, Kolec M. Traboini, na rrëfen sagën e hidhur, të gjatë e cifikultësë të familjes së madhe të Traboinëve nga qyteti i Shkodrës. Në libër, herë në stil kronologjik, herë me digresione jepet ideja e rrugës së sakrificave dhe mundimeve që kaloi një familje me shumë anëtarë për shkak të përndjekjeve dhe synimit të Sigurimit për ta nënshtruar. Në rrëfimin e Kolec Traboinit përvijohet klavari i vetes dhe i vëllezërve të tij nëpër kamp-burgjet e komunizmit. Ndonëse flet për ngjarje të trishta e tragjike, autori e ruan optimizmin, shpresën dhe humorin e zi.

**Titulli: "Në kërkim të ditëve premtuese" - refleksione**

**Autori: Sami Repishti**

Ky libër është një përmbledhje esesh dhe artikujsh të autorit të njohur Sami Repishti, i cili, edhe pse i ka kaluar të 90-tat, vazhdon të jetë aktiv, duke mbetur një kontributor i rëndësishëm në zbardhjen e të shkuarës komuniste. Autori vuajti 10 vjet burg (1946-56), në kampet më të vështira, si Vloçisht e Pojan të Korçës, Beden të Kavajës, etj., derisa u lirua më 1956. Tre vjet më vonë u arratis nga Shqipëria.

Përmbajtja e këtij libri, e bazuar në përvojën e autorit dhe të tjerëve, është një dëshmi, analizë dhe thirrje për reflektim, e realizuar nga një person që e shikon si detyrë rrëfimin, dëshmimin e krimeve të regjimit komunist, në emër të tij dhe bashkëvuajtësve të tij. Të shkruash për regjimin komunist, nga këndvështrimi i viktimës, është, sipas autorit, "detyrë parësore morale me thanë fjalën që mijëra bashkëvujtës të mi [që] nuk patën mundësinë me shqiptue, as me shkruë, me gishta të thyem nga torturat shtazarake, në hetuesitë e bishave komuniste të Sigurimit të Shtetit, ose të këputun shkurt nga plumbi i ekzekutimeve masive..."

Autori përpiket të shpejtojë se hija e regjimit komunist, "kësaj periudhe të errët", vazhdon akoma, "e randë, e dendun, e paturpshme," për shkak të prodhimit që ajo ofroi: "Nji elementi të indoktrinuem që në fëmëni, ose të korruptuem nga trajtimi "preferencial" i nji "autoriteti" që refuzon me vdekë tue pengue kështu lindjen e brezit të ri të liruem nga trashëgimia e së kaluemes sonë tragjike."

Autori vlerëson qëndrimin e lartë moral të viktimave të komunizmit, të cilat, pas rënies së atij regjimi, refuzuan të udhëhiqeshin nga urrëjtja dhe hakmarrja kundër njerëzve që i shërbyen atij regjimi. Tani, sipas tij, është koha për të hedhur hapin e dytë: "Pajtimin në mes nesh, individual e

kolektiv."

**Titulli: "Mos harroni, jemi edhe ne" vol. II (refleksione)**

**Autori:** Reshat Kripa

Kjo përmbledhje esesh dhe artikujsh të autorit Reshat Kripa është një kolazh temash të ndryshme, të cilat lidhen me persekutimin komunist, falsifikimin e historisë së autorit, ose me profile personazh nga radhët e viktimave të komunizmit.

Autori shkruan për përvojën e tij në burgjet e komunizmit dhe të personave të tjerë, ai shkruan gjithashtu për nevojën e krijimit të një gjykate për dënimin e krimeve të komunizmit.

Ai sjell raste ekstreme të krimve të regjimit komunist, siç ishte vrasja e dy të rinjve në Srandë, më 1985. Të rinjtë, të cilët tetntuan të arratiseshin nga deti, nuk u arrestuan, por u masakruan me elikat e motobarkës së forcave të regjimit. Jo vetëm kaq, njëri nga prindërit nuk guxoi as të kërkonte kufomën e të birit, ndërsa prindi tjetër, i cili e mori kufomën, nuk e varrosi dot në fshatin e tij, sepse nuk e la orgnaizata e partisë së fshatit.

Ai shkruan në nderim të ish-bashkëvuajtësve të tij të burgut.

Ai shkruan për shqetësimet e ditës të ish të përndjekurve politikë ose për temat e nxehta të historisë, për hapjen e dosjeve dhe mënyrën si mund të ishin hapur ato, etj.

Në libër janë përfshirë dhe shkrime rreth librave të ndryshëm që i kanë lënë mbresa autorit, apo që e kanë grishur me përmbajtjen e tyre, por gjithmonë janë libra që flasin periudhën e komunizmit, ose, së e përkufizon autori, libra që flasin për "atë botë të zymtë e mbuluar nga dimri i tmerrshëm i quajtur komunizëm."

**Titulli: "Karuseli i totalitarizmit" - shënime mbi kujtesën dhe kulturën**

**Autor:** Islam Spahia

Libri është përmbledhje me portrete të dënuarish politikë që autori i ka njohur në burg, kujtimesh, refleksionesh mbi diktaturën dhe intervista të autorit me përmbajtje nga përvoja e tij e burgut, si i dënuar politik.

Autori kreu studimet në Liceun artistik (1946-1950), por nuk iu dha mundësia të studionte më tej. Ai vuajti internim (1970- 1975) dhe burg (1976-1982). Në këtë libër, në kujtim të bashkëvuajtësve të tij, ai shkruan për disa nga bashkëvuajtësit e tij të shquar si Dom Lec Sahatçia, Zef Ashta, Dom Mikel Koliqi, Ahmet Kolgjini, Marie Shllaku, Edison Gjergo, Kristo Kirka.

Autori ka shkruar dhe një trajtesë të thelluar mbi gjenocidin, duke e trajtuar konceptin ligjor të gjenocidit, konceptin kulturor, në një përpjekje për të shpjeguar krimet e regjimit komunist në Shqipëri, të cilat jo rrallë etiketohen si gjenocid.

Në libër përfshihen dhe ese kulturore, bazuar në leximet e autorit, siç është për shembull eseja "Morsa e makinerisë diabolike diktaturës", shkruar rreth librit të Lek Tasit, "Grabriani rrëzë kodrave", një libër që flet për jetën e të internuarve në Grabian të Lushnjës. Ky libër i Tasit fitoi çmimin e Shoqatës së Botuesve, si libri më i mirë i vitit 2019, botuar nga ISKK.

### **Titulli: "Zërat e kujtesës", vëllimi VI**

**Autorë:** Luljeta LLESHANAKU, Agron TUFA

Ky është botimi i radhës i ISKK, në të cilin përmbledhen dëshmi të transkriptuara të të mbijetuarve nga burgjet dhe kampet e internimit në regjimin komunist. Rrëfimet janë të ndërtuara mbi bazën e intervistave, të cilat janë të arkivuara në formë audio-vizuale, dhe që zgjasin nga një orë deri në shtatë orë për secilin prej tyre. Nga dëshmitë e përfshira në këtë numër, sillen fakte të reja mbi burgjet dhe kampet e njohura si Burgu i Burrelit, kampi i Punës në Spaç, Qafë Bari, Kampi i Punës në maliq dhe Beden, por edhe dëshmi të dorës së parë mbi ngjarje më pak të njohura, siç ka qenë dhuna në Burgun e Tales pas revoltës së Qafë Barrit, si një mënyrë parandalimi i përshkallëzimit të revoltës në kampe të tjera. Të tjera të dhëna që zbulohet në këto dëshmi është edhe transferimi në spitalin psikiatrik i të arrestuarve në fazën e hetuesisë, dhe turturat psikologjike të ushtruara ndaj tyre. Një tjetër aspekt i palvruar më parë është arrestimi i të miturve për arsye politike, kryesisht për tentativë arratisje. Dëshmi të kësaj natyre, i paraprijnë studimeve të veçanta të cilat do të trajtohen në konferenca të parashikuara së afërmi na ky Institut, të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve në shtetin komunist dhe abuzimin me ligjet e kohës.

### **Titulli: "Suzana Biçaku Maliqi: Gjineshtra në vullkanin e kuq"**

**Autor:** Denis Gila

Ky libër është konceptuar në formë e një interviste të gjatë me zonjën Suzana Biçaku Maliqi, një nga gratë e persektuara ng regjimi komunist. Në formën e dëshmimeve, zonja në fjalë, e lindur në një familje patriote, pjesë e parisë së kombit shqiptar me ndjenja të forta filantropike, që në fëmijëri i takon të ndeshet me sfida të papërballueshme mbijetese, duke qenë qëprindërit i burgosen politikisht, dhe ky fakt e përndjek atë dhe pjesën tjetër të familjes deri në rënien e egjimit. Por ndryshe nga pjesa më e madhe e viktimave të kohës, familja e saj nuk ishte përzier me ploitkë, madje kishte ndihmuar forcat parizane. Por siç e zbulon e intervistuar shkakun, ishte pikërisht pasuria e të atit që e armiqësoi me pushtetin komunist, pra, i ati arrestohet vetëm që të dorëzojë florinjte, dhe pas arrestimit, ai vihet në shënjestër si armik klasik i regjimit.

Përveç tablosë së përgjithshme dhe detajeve informuese për atë kohë dhe mënyrën se si funksiononte regjimi, me interes veçanërisht për brezin e ri, është historia frymëzuese e një gruaje



e cila që në fëmijëri shfaq një forcë karakteri të jashtëzakonshëm kundrejt rrethanave. Suzana, arriti të shoh të bukurën edhe në dhunën që ushtronin ndaj saj, arriti të fitonte mbi urrejtjen, mbi poshtërimin, mbi arrogancën, mbi padijen. Ajo vendosi në plan të parë njeriun, u mbështet tek dinjiteti për të përballuar një jetë të vështirë, në kufijt e absurditetit. Pra, libri paraqet interes jo vetëm aspektin historik, por edhe atë sociologjik dhe psikologjik.

### **3.3 Literaturë nga burgjet/kampet**

**Titulli: Realizëm i dënuar (Panteoni i nëndheshëm)**

**Autori:** Visar Zhiti

Libri është një sprovë, një punë që përmbledh vite hulumtimesh dhe përsiatjesh për të sjellë një tablo të pasuruar të letrave shqipe, të saj që mungoi, dukuri dhe vepra të një letërsie tjetër, që doli nga burgjet, internimet dhe harresa vrastare, nën diktaturë gjatë viteve 1945-1990.

Kjo letërsi, e krijuar nga autorë të lënë harresë, të burgosur, shpesh të vdekur burgjeve, por dhe të pushkatuar, solli të vërteta të mëdha, përgjegjshmëri dhe ndërgjegje kolektive, moral të lartë njerëzor dhe është bërë tashmë pjesë e qenësishme e letërsisë shqipe, e kulturës kombëtare, e dhimbjes dhe e dashurisë së popullit tonë.

Sipas sprovës, kjo letërsi nuk erdhi për të zëvendësuar letërsinë e krijuar gjatë atyre viteve, kur në Shqipëri sundoi diktatura më egër në të gjithë Europën e Lindjes, por që të sjellë vetveten, duke i shtuar letrave shqipe kështu pamje të tjera, të munguara më parë dhe pak të studiuara.

Në mbi 400 faqet e këtij punimi me shumë interes shtjellohen, krahas biobibliografive të një sërë autorë, edhe ide, qendrime, polemika, që e bëjnë librin të ketë informacionin e një enciklopedie dhe dobishmërinë e një doracaku, duke mbetur ndërkohë një vepër e kritikës letrare, eseistike e të vërtetave dhe dokumentit.

## **4. PARTNERITETE**

### **4.1 Partnerë vendas**

- Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë
- Ministria e Arsimit dhe e Shkencave të Shqipërisë
- Autoriteti për Informimin mbi Dokumentimin e Ish-Sigurimit të Shtetit
- Muzeu historik “Shtëpia e gjetheve”
- Instituti për Demokraci, Media dhe Komunikim
- Universiteti i Tiranës, Departamenti i Historisë
- Instituti i Shkencave Politike
- Ministria e Kulturës së Shqipërisë
- Qendra Musine Kokalari
- Biblioteka Kombëtare
- Instituti i Traumës dhe Rehabilitimit
- Akademia e Multimedias MARUBI
- Forumi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut
- Shoqatat e Ish të Përndjekurve politikë

### **4.2 Partnerë ndërkombëtarë**

- Fondacioni “Konrad Adenauer”, në Tiranë (partner kryesor)
- Bundesstiftung zur Aufarbeitung der SED-Diktatur (Gjermani)
- Albanian Human Rights Project (AHRP), SHBA.

- European Solidarity Centre, (“Permanent Exhibition Section”, Gdansk, Poloni.)
- Federal Foundation for the Reappraisal of the SED Dictatorship, Berlin.
- “European Remembrance” netëork, Berlin.
- The Platform of European Memory and Conscience(*Me 16 nëntor 2018, Institui i Studimit të Krimeve të Komunizmit (ISKK) pranohet anta i Platformës Europiane të Kujtesës ( The Platform of European Memory and Conscience).*)

### III. MENAXHIMI BUXHETOR

#### a. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Për vitin 2019 Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit është strukturuar në dy drejtori dhe në një sektor përkatësisht: - Drejtoria e Studimeve Shkencore, Drejtoria e Arkivës dhe Sektori i Buxhetit, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Struktura, marrëdhëniet dhe detyrat e këtyre drejtorive, rregullohen përveç legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi edhe nga rregullorja e brendshme e institucionit, e cila ka përcaktuar në mënyrë të detajuar funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat për kryerjen e veprimtarisë së secilës prej këtyre drejtorive dhe sektorit.

Emërimi i personelit të institucionit, është bërë në zbatim të ligjit nr.10242 datë 25.02.2010 “Për krijimin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” neni 13 i tij si dhe në bazë të VKM-se nr.191, datë 23.02.2011 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri”.

Në Organikën dhe Strukturën institucionit tonë janë 15 punonjës.

Gjatë vitit 2019 janë evidentuar zhvillimet e mëposhtme deri në plotësimin e të gjitha vendeve sipas strukturës:

Bazuar në pozicionet vakante të miratuara për shkak të largimeve, si dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të legjislacionit të shërbimit civil apo Kodit të Punës, u krye procesi i rekrutimit dhe emërimit për pozicionet:

- 1 (një) punonjës administrativ (specialist/Jurist në Sektorin e Financës/Buxhetit dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Për sa më sipër dhe në zbatim të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, numri i punonjësve të ISKK për vitin 2019, ka qenë 15 punonjës.

ORGANIKA E STRUKTURA E INSTITUCIONIT TË STUDIMEVE PER KRIMET E PASOJAT E KOMUNIZMIT NE SHQIPERI

<i>POZICIONI</i>	<i>NUMRI</i>
I. DREJTORI EKZEKUTIV	1
SEKRETAR/ARKIVIST	1
II. DREJTORIA E ARKIVES/NENDREJTORI	(4)
DREJTOR DREJTORIE/NENDREJTOR	1
SPECIALIST	3
III. DREJTORIA E STUDIMEVE	(5)
DREJTOR DREJTORIE	1
SPECIALIST	4
IV. SEKTORI I BUXHETIT, FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	(4)
PERGJEGJES SEKTORI	1
SPECIALIST	2
SHOFER	1
<hr/> PUNONJËS GJITHSEJ	<hr/> 15

Gjithashtu gjatë vitit 2019, ISKK në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik”, ka depozituar në kohë Deklarimin e Interesave Privatë Periodik/Vjetor dhe Deklarimin e Interesave Para Fillimit të Detyrës, sipas legjislacionit në fuqi.

**b. Gjendja financiare e iskk për vitin 2019**

Mbështetur në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, si dhe në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 ”Për procedurat standarte të zbatimit të

buxhetit”, procesi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2019, dhe situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit të Institutit të Studime të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, për periudhën Janar - Dhjetor 2019, paraqitet si në tabelën më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Plan vjetor 2019</b>	<b>Plani i rishikuar 2019</b>	<b>Fakti mujori</b>	<b>Në %</b>
<b>1</b>	Shpenzime për Paga	19,830,000	19,205,000	15,518,046	80.8%
<b>2</b>	Sigurime shoqërore	2,970,000	2,970,000	2,385,010	80.3%
<b>3</b>	Mallra e Shërbime	11,700,000	12,362,000	6,201,441	50.2%
<b>4</b>	Shpenzime për Investime	2,000,000	2,000,000	1,896,000	94.8%
	<b>Totali i Shpenzimeve</b>	<b>36,500,000</b>	<b>36,537,000</b>	<b>26,000,497</b>	<b>71.2%</b>

Në Shpenzimet e përgjithshme, duke u bazuar në buxhetin e vitit 2019 në fund të këtij viti, kanë arritur në 26,000,497 lekë, nga 36,537,000 lekë që është buxheti i rishikuar për vitin 2019, duke u realizuar në masën 71,2% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 10,536,503 lekë. Shpenzimet korente në fund të vitit 2019, kanë arritur në shumën rreth 6,201,441 lekë ose rreth 50.2% e buxhetit të rishikuar, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 6,160,559 lekë.

Gjithashtu, në tabelën e mëposhtme, evidentohet pesha e shpenzimeve sipas artikujve në raport me totalin e shpenzimeve:

<b>Artikulli</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Realizimi vjetor 2019</b>	<b>Stuktura në %</b>
<b>600</b>	Shpenzime për Paga	15,518,046	59.68
<b>601</b>	Sigurime shoqërore	2,385,010	9.17
<b>602</b>	Mallra e Shërbime	6,201,441	23.86
<b>231</b>	Shpenzime për Investime	1,896,000	7.29
	<b>Totali i Shpenzimeve</b>	<b>26,000,497</b>	<b>100</b>

Shpenzimet në fondet e buxhetit në zërin “paga dhe sigurime shoqërore” rezultojnë me mospërdorim të fondit prej 3,821,944 lekë. si pasojë e mos plotësimit që nga fillimi i vitit të vendeve vakante të numrit të punonjësve të planifikuar dhe miratuar për vitin 2019, i cili ishte 15punonjës faktik nga 19 punonjës të miratuar për shkak të mosmiratimit të ndryshimit të Strukturës dhe Organikës së ISKK nga Keshilli i Ministrave.

Sa i takon zërit “shpenzime për mallra e shërbime”, gjatë vitit 2019, rezulton me një realizim vjetor prej 6,201,441 lekë nga 12,362,000 lekë i planifikuar, pra i realizuar 50.2%, duke mos realizuar kështu zerin me te rendesishem te shpenzimeve operative qe ishte “*Faqosja dhe Shtypshkrimi i 16 librave të Kolanës për vitin 2019*” per disa nga arsyet e meposhtme Mbështetur në Vendimin nr. 807, datë 16.11.2016 “*Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore*” e procedura e prokurimit, Kërkesë për Propozim me objekt “*Faqosja dhe Shtypshkrimi i 16 librave të Kolanës për vitin 2019*” me fond limit të parashikuar në RPP në fillim të vitit prej 2.800.000 Lekë, dhe 900.000 Lekë pagesa e te drejtës së autorëve te librave nuk ka arritur te prokurohet pasi vonesa në fillimin e kësaj procedure ka ardhur si rezultat i shkaqeve të mëposhtme të cilët jane faktorë jashtë ISKK:

1. 3 (tre) nga titujt e librave të kolanës janë ndryshuar në mesin e muajit Shtator 2019 si rezultat i procesit të amendimit të ligjit të ISKK nga ana e Kuvendit, konkretisht Nenit 31 shkronja 1 mbi përcaktimin e objektit të studimit për ISKK të “periudhës së sistemit komunist”, pasi në kolanën e parashikuar të botimeve bënin pjesë libra që preknin periudhën e Luftës Nacionalçlirimtare ose atë para vitit 1944. Si rezultat, në përputhje me zhvillimet e fundit parlamentare, u desh që këto 3 tituj (libra) të zëvendësoheshin me 3 tituj (libra) të tjerë, për të cilët u nevojiti përsëritje e gjithë procesit të vlerësimit të dorëshkrimeve për botim, meqenëse dorëshkrimet vlerësohen në grup, dhe i gjithë riciklimi i procesit mori kohë plus, siç mori kohë plus edhe procesi i punës përzgjedhëse, dhe përgatitjes për shtyp. Kjo situatë çoi që miratimi perfundimtar i 16 librave të Kolanës për vitin 2019 të vonohej në kohë, duke përfunduar nga Keshilli Shkencor dhe Bordi Drejtues vetëm në datën 18.10.2019.
2. Një nga aktivitetet e planifikuar për në muajin dhjetor 2019, ishte një workshop trajnimi, i cili nuk arriti të realizohej për shkak të bllokimit të fondit nga situata emergjente e krijuar nga tërmeti. Bëhet fjalë për një workshop trajnimi mbi trashëgiminë materiale të komunizmit, i cili ishte përfshirë edhe në ‘Vizionin e vitit 2019’, në raportin vjetor të vitit 2018 të ISKK drejtuar Kuvendit. Objekti i këtij workshopi trajnimi ishte trajnimi i grupeve vullnetare nga antropologë dhe ekspertë muzesh, mbi gjetjen e artefakteve që simbolizojnë këtë periudhë dhe krijimin e një network-u me institucione të tjera të kujtesës dhe arsimore posaçërisht mbi këtë temë. Dy nga trajnuesit, ishin parashikuar të ishin ekspertë të huaj. Kështuqë, na u desh anulimi i ftesave dhe i shpenzimeve të parashikuara për këtë aktivitet tre-ditor, përfshirë edhe koston e dy të ftuarve të huaj (shpenzime udhëtimi, akomodim për katër netë, etj). Vlera e këtij aktiviteti ishte parashikuar në shifrën 600.000 lek.

Ndërkohë, shpenzimet kapitale deri në fund të vitit 2019, janë realizuar në masën 1.890,000 lekë pra ne masen 94.8%, duke realizuar kështu blerjen e nje automjeti per vitin 2019.

Nga sa më sipër rezulton se, në përgjithësi të gjithë zërat e buxhetit janë realizuar në masën e planifikuar në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2019-2021.

Shpenzimet më të rëndësishme dhe të domosdoshme për ISKK janë realizuar me efikasitet, duke bërë që puna të vijojë me efektshmëri dhe duke plotësuar nevojat e punonjësve për një mjedis të përshtatshëm pune.

### **Përmbledhëse nga Auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit**

Instituti për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në zbatim të Programit të Auditimit, nr 360/2, datë 29.05.2019. KLSH ka përfunduar punën audituese në ISKK në datën 10.07.2019. Periudha e auditimit është 01.01.2018 deri në 30.05.2019, dhe rezultat e punës janë pasqyruar në Raportin Përfundimtar ku përfshihen gjetjet dhe konkluzionet përkatëse. Më hollësisht ju informojmë:

#### **A. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME TË LEGJISLACIONIT NË FUQI.**

1. Në këto kushte rekomandojmë, që ISKK ti drejtohet Kuvendit për shfuqizimin e:
  - Pikës 2 të nenit 19 të Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” i cili parashikon se: “Struktura, organika dhe niveli i pagave të punonjësve të institutit miratohen me VKM” dhe
  - Nenit 20 të po të njëjtit ligj ku përcaktohet se “Ngarkohet KM të miratojë strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të nëpunësve e punonjësve të tjerë të Institutit dhe shpërblimeve brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas përcaktimeve të bëra nënenet 12 dhe 19 të këtij ligji”

**Për këtë:** Rekomandimi ka gjetur zbatim. Komisioni i Ligjeve pranë Kuvendit të Shqipërisë ka pranuar kërkesën për **shfuqizimin** e neneve të mësipërme të ligjit të ISKK dhe e ka kaluar atë për miratim në Parlamentin e Shqipërisë.

#### **B. MASA ORGANIZATIVE.**

- 1.1 Me qëllim menaxhimin efektiv të fondeve buxhetore, nevojitet planifikimi aktiv, dhe monitorimi i kujdesshëm i buxhetit.
- 2.1 Të merren masa që të bëhet veprimi korrigjues duke evidentuar çrregjistrimin e 175 librave me vlerë kontabël 169,450 lekë nga llogaria 312107 “Libra dhe Publikime Profesionale”, dhe rregjistrimi në llogarinë 2120112 “Krijim Fond Biblioteke”.
- 3.1 Nëpunësi Autorizues (NA) të marr masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të automjetit me qëllim që mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e mbajtjes në punë, vlerësimi kosto-përfitim, të bëhet vlerësimi i tij.

- 4.1 Nëpunësi Zbatues (NZ) të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- 5.1 Nëpunësi Zbatues (NZ) të marrë masa që në vijim të mos përlllogarisë për veprat e artit dhe për këtë kategori aktivesh të kryejë veprimet korrigjuese për amortizimin e përlllogaritur deri tani.
- 6.1 Në të gjitha procedurat e prokurimit që do të kryhen në të ardhmen, Njësia e Prokurimit të marrë masa që të hartojë dhe miratojë Dokumentat e Tenderit, nëpërputhje më Dokumentat Standarte të Tenderit për kontratat e furnizimeve (mallrave).
- 7.1 Për të gjitha rastet e shërbimeve të kesaj natyre, që lidhen më blerjen, zhvillimin dhe prodhimin, bashkëprodhimin e programeve ose të reklamave, ISKK të procedojë në zbatim të VKM nr.1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkërendimin e programeve të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në mediat e shkruara, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administrates shtetërore”, dhe jo në zbatim të ligjit për prokurimin Publik dhe Akteve të dala në zbatim të tij.
- 8.1 **a.** Titullari i njësisë publike të marrë masa për miratimin e programeve specifike për trajnimin e punonjësve.
- b.** Titullari i njësisë publike të marrë masa për hartimin e Strategjisë së Riskut të ISKPK-së me qëllim mirë funksionimin e kontrolleve të brendshme. Të ngrihen grupet e punës për miratimin e regjistrave të riskut.
- c.** Në çdo rast, GMS të marrë masa për të përgatitur një raport vjetor me qëllim kontrollin se si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike.
- d.** Të merren masat që të plotësohen vlerësimet për 6-mujorin e vitit 2019 sipas të gjithë proceseve që dikton baza ligjore në fuqi.
- 9.1 Nga sa më sipër nevojitet që Bordi të marrë masa që të miratojë procedurat e marrjes në punë të punonjësve të rinj. Procedurat e rekrutimit të miratuara nga Bordi , të bëhen pjesë e Rregullores së Brendshme të funksionimit të Institutit.
- 10.1 Rekomandojmë që, në përputhje me kërkesat e Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e ISKPK”, korrespondenca e protokolluar, pasi t’i bashkëlidhet kartela shoqëruese, t’i përcillet titullarit, për dhënien e udhëzimeve mbi trajtimin e secilës praktikë. Edhe në rastet kur një shkresë nuk i drejtohet Titullarit, korrespondenca duhet të ndjekë potë njëjten rrugë administrative. Sipas shënimeve për mënyrën e trajtimit, të bëra nga titullari, korrespondenca t’u dërgohet funksionarëve për ndjekjen e tyre, nëpërmjet sekretarisë.

**Të gjitha rekomandimet e mësipërme pa asnjë përjashtim kanë gjetur zbatim brenda afateve dhe deri në datën 31.12.2019.**



#### IV. VIZIONI PËR VITIN 2020

Për vitin 2020, ISKK tashmë e ka një plan aktivitetesh të miratuar edhe nga Bordi Ekzekutiv i këtij Instituti, ku peshën kryesore e zënë projektet aftagjata, siç janë: database dhe ‘Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Komunizmit’; pasurimi i video-arkivës së dëshmive të regjistruara dhe seria e botimeve ‘Zërat e kujtesës’, seria e filmave dokumentarë të muzeve virtualë të bugjeve dhe kampeve komuniste me ndihmën e grafikës 3D; si edhe projektet në bashkëpunim me institucionet arsimore, në vijim të marrëveshjes më Ministrinë e Arsimit.

Por, nëse në 2019 ka qenë prioritet trashëgimia materiale, në vitin 2020, është planifikuar t’i jepet prioritet ligjshmërisë në shtetin komunist. E thënë ndryshe: ndërsa tashmë ekziston deridiku një lloj informacioni i përgjithshëm në lidhje me krimet e kryera dhe dhunimin e të drejtave të njeriut në shtetin totalitar, pak është diskutuar për termat ligjore, kontekstin ligjor përtej akteve të dhunës, persekutimit, dhe gjithë kuadrin ligjor që shoqëroi procesin e dehumanizimit nën diktaturë. Cilat janë fazat e evolimit të ligjit socialist; si ia doli socializmi shtetëror të vinte kontroll të përgjithshëm mbi çdo sferë të jetës shoqërore në shërbim të një qëllimi të vetëm; cila ishte mendësia revolucionare në hartimin dhe zbatimin e ligjit; çfarë argumentimi ligjor ekziston përtej akteve të dhunës dhe persekutimit; cilat janë mospërputhjet e kushtetutës me kodin penal; cilat janë abuzimet dhe aktet e paligjshme në zbatimin e vetë ligjshmërisë së kohës; cila është përgjegjësia shtetërore dhe ajo individuale në këtë drejtim—janë disa nga çështjet që do të shtrohen në një konferencë që ISKK planifikon të realizojë në muajin tetor, pikërisht mbi këtë temë: drejtësia në shtetin komunist.

Diskutimi për nga aspekti ligjor i kampeve të punës, do të jetë një nga çështjet e trajtuara edhe në konferencën mbi Kampin e Punës së Maliqit, e cila do të mbahet në muajin qershor, si edhe në një ekspozitë grafike me dokumente të afishuar nga proceset e hetuesisë dhe gjyqet. Ndërsa studimi “Abuzimi me pronën në Shqipërinë komuniste: 1945-1946”, që do të botohet gjatë vitit, shumë specifik në llojin e tij, do të argumentojë ilegjitimitetin e një pjese të mirë të reformave ekonomike gjatë dy viteve të para të instalimit të shtetit komunist, pra, sekustrimin e pronës në kuadrin ligjor të kohës.

Me ekskluzivitetin që do t’i jepet në 2020 analizimit të ligjshmërisë gjatë regjimit komunist, ISKK synon të argumentojë ilegjitimitetin e shtetit komunist, degradimin e të drejtave civile si pasojë e degradimit të sistemit të drejtësisë, dhe përgjegjësitë që vijnë nga ky proces.

Rritja e aksesit në sektorin e edukimit, do të vazhdojë të jetë një tjetër përparësi gjatë vitit 2020. Biedat në universitete, shkolla të mesme dhe në ato nëntëvjeçare, do të jenë më interaktive tashmë, me shfaqjen e dokumentarëve të ISKK dhe mjeteve të tjera të komunikimit vizual. Ndërkohë,

takimeve në shkolla, do t'i paraprijë një ëorkshop me mësuesit dhe ekspertë të shkencave pedagogjike, duke marrë si shkak botimin e librit me ilustrime mbi jetën e Sabiha Kasimatit. Me pak fjalë, gjatë vitit 2020 do t'i kushtohet vëmendje e veçantë strategjisë së qasjes, për një impakt më të fuqishim tek të rinjtë.

FALEMNDERIT!

Përgatiti raportin:

**Drejtori Ekzekutiv i ISKK**

Çeo HOXHA

Tiranë, 19 shkurt 2019